# GAZETA SHQIPTARE




Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com




Viti XXIV - Nr. 7550 E martë 5 Qershor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinioni i Ditës

Nga VALBONA NATHANAILI

## Universitet privat apo publik?



Debati për zhvillimin e universiteteve jo rrallë reduktohet në ndarjen e tyre në publikë e private dhe më pas, në shtjellimin e argumenteve dhe...

Vijon në faqen 20

Opinioni i Ditës



Nga ILIR KALEMAJ

## Ata po vijnë

Zgjedhjet e fundit në Itali tërhoqën vëmendjen ndër të tjera edhe për kërcënimin e ministrit të ri të Brendshëm, Salvinit për deportimin e rreth gjysmë ....

Vijon në faqen 21



Skemat e vlerësimit për të 4 gjuhët në variantet A dhe B

# Matura Shtetërore, zbardhen përgjigjet e sakta të provimit të Gjuhës së Huaj

Nxënësit: Kohë e pamjaftueshme për Gjuhë- Letërsinë, do të donim një javë afat

VOLTIZA DURO

Ditën e djeshme rreth 37 mijë maturantë në mbarë vendin iu nënshtruan provimit të parë të Maturës Shtetërore 2018-të. Testimi i gjuhës së huaj me 25 pyetje, përgjithësisht u konsiderua i thjeshtë; por ka pasur edhe nxënës ...

Në faqet 10-11

BASHKEPUNIMI KUNDER DHUNES, KRYEMINISTRI HARADINAJ BEN DEKLARATEN BOMBE

# "TERRORISTET KANE HEDHUR PARA NE KOSOVE E SHQIPERI"

Princi i Jordanisë: Ekstremizmi, një sfidë ideologjike. Zv/ministrja: 15 vjet burg për mbështetjen e terrorizmit, prioritet kthimi i grave e fëmijëve të mbetur në Siri




(Në foto) Kryeministrat Rama, Haradinaj, Borisov dhe princi i Jordanisë, dje në konferencën kundër ekstremizmit

Në faqen 2

MIRATOHEN NDRYSHIMET

## Statusi i gjyqtarëve kërkon 84 vota, PS tenton konsensusin e LSI, PD mungon në komision

Në faqen 4

SKEMA E POLICISE

## Furnizoheshin me drogë nga shqiptarët, pranga ultrasit të Milanit dhe rojës së Interit

Në faqen 8

INTERVISTA

## Përgjysmim tarifash për lejet e qëndrimit të emigrantëve në Greqi, Malaj: Kur hyn në fuqi

Në faqen 9

VENDIMET 1993-2008

## Pronarët në Shkodër, ATP merr në shqyrtim 4400 dosje, procedurat për t'u njohur me ecurinë

Në faqet 18-19

HYDROTERAPIA



## Doktor Fejzo: Liqeni kurues i Shënepremtes, nga artriti te astma e anemia, ja çfarë shëron

Në faqet 14-15

Lista e plotë emërore e banorëve që marrin certifikatën e pronësisë

# Hipoteka shpërndan 250 tapi në qarkun e Tiranës

*ALUIZNI: Përfituesit kanë ndërtuar pa leje ndër vite*

Nga ORNELA MANJANI

Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme publikon listën e 250 personave që marrin edhe certifikatën e pronësisë, pasi janë pajisur me leje legalizimi. Këtyre familjeve, banorë të qarkut Tiranë, u jepet në dorë hipote-



ka e pronës, duke përmbyllur kështu një cikël të gjatë e të shumëpritur. Procedurat për marrjen e tapisë janë ndjekur nga ALUIZNI, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme publikon listën e 250 personave që marrin edhe certifikatën e pronësisë ...

Në faqen 7

ANTITERRORIZMI

KONFERENCA

Bashkëpunimi kundër terrorizmit, Rama: Toleranca fetare, një thesar për Shqipërinë

# Haradinaj: Terroristët kanë financuar njerëzit e tyre në Kosovë dhe Shqipëri

## *Princi i Jordanisë: Ekstremizmi, një sfidë ideologjike*




Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama, kryeministri i Kosovës Ramush Haradinaj dhe princi i Jordanisë Ghazi Bin Muhammad, dje në konferencën "Së bashku kundër ekstremizmit të dhunshëm"

Darina Tanushi

Bashkëpunimi në luftën ndaj terrorizmit dhe ekstremizmit u diskutua dje, në Tiranë në një konferencë me temë "Së bashku kundër ekstremizmit të dhunshëm", ku mori pjesë princi i Jordanisë Ghazi Bin Muhammad. Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama nënvizoi rëndësinë e bashkëjetesës mes komuniteteve fetare në Shqipëri, madje duke e konsideruar një thesar që duhet ruajtur. Ky aktivitet bëhet në kuadrin e Procesit të Aqaba, ku mendohej të merrte pjesë edhe Mbreti Abdulla i Dytë i Jordanisë, por nuk ka mundur për shkak të problemeve në vendin e tij. "Është e vërtetë që ne kemi këtë trashëgimi fantastike të mrekullueshme. Ndonjëherë duket goxha mbresëlënëse, goxha e mrekullueshme, nga njëra anë, kur shihet kjo vëllazëri ndërkufitare, ndërsa në anën tjetër shihet mungesa e vëllazërisë mes politikanëve. Por ajo çka është shumë e rëndësishme sot e kësaj dite është të kuptojmë që kjo nuk është diçka e dhënë, është një trashëgimi e ndërtuar brez pas brezi në rrethana shumë të ndryshme, ndonjëherë edhe shumë tragjike",-u shpreh Rama. "Ne po mundohemi të bëjmë më të mirën tonë dhe do të vazhdojmë ta bëjmë diçka të tillë",-u shpreh më tej, Rama. "Kur mendojmë për terrorizmin dhe radikalizmin, ne gjithmonë priremi të mendojmë që është një çështje kufijsh dhe vijash shumë të mirëpërkufizuara dhe një problem me të cilin duhet të përballemi ballë për ballë dhe që është një çështje e forcave përfundimtare. Por, faktikisht, në themel është një luftë që bëhet në zemrat e njerëzve. Kështu që të fitojmë zemrat dhe mendjet e njerëzve është shumë më e komplikuar dhe e ndërlikuar, sesa të fitosh një betejë në një fushëbetejë dhe të pushtosh një territor, apo të largosh nga një territor një forcë keqbërëse dhe keqdashëse për një periudhë të caktuar kohe. Pra, është një betejë e vazhdueshme dhe me të gjitha këto që po ndodhin, me teknologjinë, me internetin dhe me rrjetet sociale, lufta nuk do të luftohet më thjeshtë, do të jetë akoma më e vështirë për ta luftuar atë",-tha kryeministri Rama. Ai tha se kjo betejë duhet filluar me fëmijët. "Toleranca fetare është një thesar i vërtetë, që ne duhet ta mbrojmë. Brezat e ardhshme duhet të jenë të ndërgjegjshëm për këtë thesar",-tha Rama.

### FINANCIMI

Ndërkaq kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj ka folur me shifra mbi hetimet që po zhvillohen ndaj mbështetësve, ndërsa dha alarmin për financime që sipas tij po bëhen me paratë e terrorizmit në Kosovë dhe në Shqipëri. "Historia jonë dhe harmonia jonë na ndihmon në këtë rrugë. Ne kemi një identitet që është me të vërtetë i fuqishëm i pasur. Ata nuk janë islamik, por janë terroristë. Ata e akuzojnë rrjetin islamik dhe fatkeqësisht kanë financuar dhe kanë disa nga njerëzit e tyre në Kosovë dhe në Shqipëri. Kosova është e ndërgjegjshme sa i përket rrezikut të terrorizmit. Si vend i vogël ne kemi pasur disa qytetarë që janë drejtuar në luftën. Në Siri ka akoma kosovarë dhe fëmijë. Ka një proces hetimi në Kosovë dhe 35 janë vënë në pranga",-u shpreh Haradinaj. Por ai shtoi se "në Siri ka akoma 59 kosovarë burra dhe 49 gra dhe 59 fëmijë që lindin atje. Në Kosovë janë kthyer 23 burra, 7 gra dhe 3 fëmijë". Nga ana e tij, Princi i Jordanisë Ghazi Nin Muhammad tha se ekstremizmi është një sfidë ideologjike, në Jordani ka programe të posaçme për ata që kthehen nga ISIS. Ndërsa e quajti ekstremizmin një sfidë ideologjike, ai tha se në Jordani ka programe të posaçme për ata që kthehen nga ISIS. "Nëse e shohim faktorin ideologjik, si faktorin shtytës, ka edhe faktor tërheqës. Zoti i përgjigjet edhe lutjeve të atij që ka bërë gabim. Edhe ata që kanë qenë luftëtarë, edhe ata që kanë vepruar gabim, Zoti u lejon atyre të kthehen",-u shpreh ai.




**GHAZI NIN MUHAMMAD**

"Ekstremizmi një sfidë ideologjike, në Jordani ka programe të posaçme për ata që kthehen nga ISIS",-u shpreh dje, Princi i Jordanisë, Ghazi. "Është shumë i rëndësishëm shpirti i ndërkombëtarisë në këtë proces, sepse problemi qëndron përtej kufijve. Përgëzoj Kryeministrin dhe Shqipërinë për këtë gjë që po mbështet", - tha princi Ghazi.



**RAMUSH HARADINAJ**

"Historia jonë dhe harmonia jonë na ndihmon në këtë rrugë. Ne kemi një identitet që është me të vërtetë i fuqishëm i pasur. Ata nuk janë islamik, por janë terroristë. Ata e akuzojnë rrjetin islamik dhe fatkeqësisht kanë financuar dhe kanë disa nga njerëzit e tyre në Kosovë dhe në Shqipëri",-tha dje, kryeministri kosovar.



**DEKLARATA**

"Egoizmin e disa prej vendeve Europiane duhet ta kapërcejmë. Edhe ne në Bullgari duhet të bëjmë më shumë akoma. Meqenëse jemi në Shqipëri, mendoj se duhet t'i jepet një datë, që së bashku me liderët e saj po bën përpjekje dhe ne duhet ta mbështesim këtë në luftën kundër ekstremizmit", - theksoi kryeministri bullgar.

**STRATEGJIA**

Në Strategjinë Kombëtare Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, janë parashikuar një gamë e gjerë programesh që synojnë mobilizimin e të gjithë aktorëve politikë e shoqërore në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, por edhe për të ruajtur e mbrojtur vlerat e shoqërisë sonë, të cilat mbeten: shteti i të drejtës, barazia sociale dhe liritë themelore të njeriut.

## Romina Kuko: Prioritet, kthimi i grave e fëmijëve të mbetur në Siri

Mbështetja financiare për terrorizmin dënohet me jo më pak se 15 vjet burg, bëri të ditur zv-ministrja e Brendshme, Romina Kuko në "Konferencën Rajonale kundër Ekstremizmit të Dhunshëm" që u zhvillua në Tiranë. "Shqipëria ka zhvilluar një sërë instrumentesh dhe mekanizmash, vendas dhe ndërkombëtar, për t'u ballafaquar me ekstremizmin e dhunshëm. Ndryshimet e fundit përfshijnë ndryshimin e nenit 230 të Kodit Penal, për të përfshirë krimet e natyrës terroriste, me qëllim të shpërndarjes së panikut mbi popullsinë, ose duke synuar dhe shkatërruar strukturat themelore politike, kushtetuese, ekonomike apo shoqërore të shtetit. Neni 230/a merret me mbështetjen financiare për terrorizmin, duke e dënuar atë me jo më pak se 15 vjet burgim, ndërsa 230/b merret me mbështetjen e fshehtë financiare për aktet terroriste", - tha Kuko. Duke bërë të ditura masat që janë marrë edhe si detyrime ndërkombëtare për luftën kundër terrorizmit, Kuko tha më tej se është hartuar "Plani i Veprimit Ndërinstitucional" për pritjen dhe trajtimin e shtetasve shqiptarë gjatë kthimit nga vendet në konflikt Siri/Irak, njëkohësisht është përpiluar projektvendimi për miratimin e këtij drafti. Zv-ministrja e Brendshme, Romina Kuko, tha se prioritet mbetet kthimi i shqiptarëve që ndodhen në zonat e luftës, në Siri dhe Irak. Ajo shtoi se Shqipëria ka forcuar bashkëpunimin me CIA-n apo FBI-në. Dhjetëra gra e fëmijë kanë mbetur në zonat e luftës në Siri, pasi prindërit e bashkëshortët e tyre janë vrarë gjatë pjesëmarrjes në luftime.



REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA: **Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu:*** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com***, **ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu:*** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**




**EDI RAMA**
Kryeministri Rama i dorëzoi homologut bullgar Medaljen e Mirënjohjes në shenjë falënderimi që Bullgaria ka bërë duke e vendosur "axhendën e Ballkanit Perëndimor si shtyllën kurrizore të programit të Presidencës, por edhe duke bërë avokatin e Ballkanit Perëndimor, të Shqipërisë dhe të Maqedonisë posaçërisht, gatë të gjithë kësaj periudhe".

**BOJKO BORISOV**
"Ballkani Perëndimor është temë më e vështirë që mund të zgjidhet, por është një temë me rëndësi, sepse në Ballkan, nëse njëri nga fqinjët është keq, të gjithë janë keq. Sa më mirë të jetë rajoni i ndërlidhur me njëri-tjetrin, aq më të mëdha janë perspektivat për investime, paqe dhe prosperitet,"-u shpreh Kryeministri bullgar.

## Borisov me Ramën: Qendër koordinimi në Shqipëri për luftëtarët që kthehen nga ISIS

# Kryeministri bullgar në Tiranë: 3 vende ende skeptike për negociatat

### "Përpjekje që t'i bindim për një datë edhe pse me kusht"

Darina Tanushi

Kryeministri i Bullgarisë, Bojko Borisov, vendi i të cilit mban Presidencën e radhës së BE-së deklaroi dje, në Tiranë mbështetjen për çeljen e negociatave të Bashkimit Europian me Shqipërinë. Gjatë deklaratës së përbashkët me kryeministrin shqiptar, Edi Rama, tha se janë dy tre vende që janë skeptike ndaj Shqipërisë për sa i përket hapjes së negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Europian. "Kuptohet, thotë Merkel: Ballkani perëndimor është tema më e vështirë që mund të zgjidhet, por është një temë me rëndësi, sepse në Ballkan, secili nga fqinjët të jetë keq, të gjithë janë keq. Sa më shumë të jemi të ndërlidhur me njëri-tjetrin, aq më të mëdha janë mundësitë për investime, paqe dhe prosperitet. Është e vërtetë që tregojmë përpjekje të shumta. Kemi akoma dy -tre shtete që janë skeptike ndaj Shqipërisë, por shumica e vendeve europiane mendojnë se edhe pse me kusht, Shqipërisë duhet t'i jepet një datë dhe një rrugë për fillimin e negociatave. Po bëjmë përpjekje të mëdha të bindim këto vende deri në fund të qershorit",-u shpreh Borisov. Por kreu i qeverisë bullgare bëri edhe një tjetër propozim. "Në Shqipëri të bëhet një qendër koordinimi për të gjithë luftëtarët që kthehen nga ISIS në territorin e Ballkanit. Propozova që çdo njëri prej shteteve që merr pjesë, të dërgojmë një oficer për ndërlidhje që të krijojmë një shtab më të organizuar për luftën e përbashkët",-u shpreh Borisov. "Gjithmonë shqetësohem kur dëgjoj që ushtria turke zhvillon stërvitje pranë kufirit të Kosovës, kur ka grumbullim të ushtarakëve, kur flitet për manovra. Në këtë drejtim, ne po kështu do të zhvillojmë stërvitje të përbashkëta, të forcave tona me veprime të posaçme. Gjatë muajve e viteve të ardhshme të punojmë akoma më mirë", u shpreh ai, duke lënë të kuptohet se duhet të ketë një matje forcash ushtarake.

Ndërsa nga ana e tij, kryeministri Edi Rama i vlerësoi marrëdhëniet me Bullgarinë si të shkëlqyera, duke përmendur këtu miratimin e ligjit për pakicat kombëtare. Rama i akordoi kryeministrit bullgar medaljen e mirënjohjes. "Pata nderin dhe kënaqësinë të pres sot një mik të posaçëm, kryeministrin e Bullgarisë, i cili meriton një falënderim shumë të veçantë edhe për faktin se në cilësinë e kryeministrit të vendit që ka Presidencën e Bashkimit Europian ka bërë një sforco të jashtëzakonshme, jo vetëm duke vendosur axhendën e Ballkanit Perëndimor si shtyllën kurrizore të programit të Presidencës, por edhe duke bërë avokatin e Ballkanit Perëndimor, të Shqipërisë dhe të Maqedonisë posaçërisht, gatë të gjithë kësaj periudhe",- u shpreh Rama.


Kryeministri i Bullgarisë, Bojko Borisov kryeministrin shqiptar, Edi Rama

"Në shenjë mirënjohjeje, unë pata kënaqësinë që t'i dorëzoj kryeministrit Medaljen e Mirënjohjes, që shpresoj të mbetet përgjithmonë në raftin e kujtimeve të tij, edhe pse nuk jam plotësisht i sigurt që, edhe kur të vijë radha e Presidencës tjetër Bullgare, Bojko nuk do jetë kryeministër. Por, sidoqoftë, nga kjo Presidencë mbetet kujtimi i mirë i këtij kontributi të jashtëzakonshëm që ai ka dhënë dhe po vazhdon të japë përditë, deri në fund të qershorit, kur shpresojmë të kemi një lajm pozitiv, të shumëpritur, për Shqipërinë dhe për Maqedoninë",-bëri me dije Rama. Kryeministri bullgar erdhi në Tiranë në kuadër të Konferencës së Sigurisë që u organizua në Tiranë në kuadër të Procesit të AQABA-s, nën patronazhin e mbretit të Jordanisë. Rama tha se kanë pasur mundësinë të diskutojnë "për të gjithë procesin e vështirë, por patjetër transformues dhe të domosdoshëm të reformave, të cilat Bullgaria i ka kaluar në një fazë më të hershme dhe që janë kyç, jo thjesht për t'u bërë pjesë e Bashkimit Europian, por për të modernizuar vendin dhe për të rritur mirëqenien e të gjithë njerëzve në këtë vend". Kryeministri Borisov nënvizoi marrëdhëniet shumë të mira mes dy vendeve dhe siguroi edhe nga Tirana, mbështetjen për avancimin e procesit të integrimit të Shqipërisë në BE, duke i konsideruar fillimin e negociatave shtytje përpara të procesit. "Me padurim presim konferencën në 26 qershor që do të japë shtytje të madhe në këtë proces dhe startim të proceseve reale në këtë fushë",-tha Borisov. Përmirësimi i ndërlidhjes infrastrukturore dhe dixhitale në rajon, sipas kryeministrit Borisov, do t'i afrojë edhe më shumë vendet e tij.



## Presidenti pret ish-kryeministrin italian D'Alema

### Takimi me Haradinajn, Meta: Bashkëpunim për të forcuar perspektivën europiane

Kreu i shtetit, Ilir Meta takoi dje, kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinaj. Përmes një postimi të bërë publik në profilin e "Facebook", Meta shkroi se i shprehu angazhimin e tij për bashkëpunim të ngushtë me institucionet e Kosovës në interes të rritjes së mëtejshme të njohjeve ndërkombëtare e forcimit të perspektivës europiane si dhe inkurajova vazhdimin e dialogut me Serbinë, në funksion të paqes dhe stabilitetit të rajonit. "Kënaqësi të takoja sot kryeministrin e Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj. Theksova rëndësinë e intensifikimit të mëtejshëm të shkëmbimeve ekonomike, tregtare, arsimore, turistike, kulturore dhe të gjitha formave të tjera mes dy vendeve tona. I shpreha angazhimin tim për bashkëpunim të ngushtë me institucionet e Kosovës në interes të rritjes së mëtejshme të njohjeve ndërkombëtare e forcimit të perspektivës evropiane si dhe inkurajova vazhdimin e dialogut me Serbinë, në funksion të paqes dhe stabilitetit të rajonit",-u shpreh Presidenti Meta, në rrjetin social, "Facebook". Po dje, Presidenti priti edhe ish-kryeministrin italian Massimo D'Alema. "Me mikun e mirë e të urtë, ish-kryeministrin italian Massimo D'Alema, diskutuam mbi sfidat e së tashmes që kërkojnë më shumë bashkëpunim për ndërtimin e të ardhmes së përbashkët europiane",-shkroi dje, Meta në rrjetin social, ku postoi edhe foton nga takimi.

## Ministri i Jashtëm, në Japoni për marrëdhëniet tregtare

# Bushati fton sipërmarrjet japoneze të mbështesin projektet e nisura në rajon

Ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati nisi dje, një vizitë në Japoni, gjatë së cilës, do të takohet me homologun e tij, Ministrin për Punët e Jashtme të Japonisë, Taro Kono. Ministri Bushati zhvilloi takime me ministrin japonez të Ekonomisë, Tregtisë dhe Industrisë, Hiroshige Seko, Presidentin e Federatës Japoneze të Biznesit, Yoshio Sato, si edhe mori pjesë në aktivitetin e organizuar me këtë rast nga ambasada e Shqipërisë në Tokio "Një ditë shqiptare në Tokio", për promovimin e fushave dhe veprimtarisë së biznesit shqiptar në tregun japonez dhe të Shqipërisë si një destinacion potencial për investitorë japonezë."




Në takimin me ministrin e Ekonomisë, Tregtisë dhe Industrisë, Hiroshige Seko u diskutua në lidhje me stadin aktual të marrëdhënieve ekonomike, intensifikimin e mëtejshëm të tyre dhe përqendrimin në fusha specifike si infrastruktura, turizmi dhe bujqësia. Ai e njohu ministrin Seko me progresin e Shqipërisë në rrugën e integrimit në BE dhe ftoi përmes tij, qeverinë dhe sipërmarrjet japoneze të mbështesin projektet e iniciuara përmes nismave të tjera në rajon, në kuadër edhe të Procesit të Berlinit dhe të partneritetit strategjik që Japonia ka me BE. Ministri Seko ftoi sipërmarrjet shqiptare që të marrin pjesë në panairin Expo Osaka 2025 si një mundësi e mirë e prezantimit të produkteve shqiptare në tregun japonez". Në fjalën e tij në aktivitetin "Një ditë shqiptare në Tokio", ministri Bushati nënvizoi se "Shqipëria është një vend me potencial të lartë për të investuar dhe një platforme solide për zgjerimin e investimeve japoneze në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

DREJTESIA

KONSENSUSI

PS miraton në parim ndryshimet: KLD dhe kryeprokurori të bëjnë emërimet në drejtësi

# Statusi i gjyqtarëve me 84 vota, PS tenton konsensusin e LSI

## PD mungon në komision, Manja: Duam konsensus



Gjatë një seance parlamentare

Valentina Madani



**NDRYSHIMET**
Partia Socialiste po tenton të marrë konsensusin e Lëvizjes Socialiste për Integrim, për ndryshimet në ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Demokratët munguan dje në komision, Nasip Naço i LSI-së doli kundër, por kryetari i Komisionit Ulsi Manja e shtyu votimin nen për nen, duke theksuar se do kërkojë konsensus.

Mazhoranca e majtë nuk ka dot votat e mjaftueshme për të kaluar në Kuvend ndryshimet në ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndaj për të siguruar 84 votat e mjaftueshme ajo po tenton drejt LSI-së. Partia Socialiste po tenton të marrë konsensusin e Lëvizjes Socialiste për Integrim, për ndryshimet në ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Demokratët munguan dje në Komisionin kuvendor të Ligjeve, ndërsa Nasip Naço i LSI-së doli kundër, por kryetari i komisionit Ulsi Manja e shtyu votimin nen për nen, duke theksuar se do kërkojë konsensus. Lëvizja Socialiste për Integrim, doli kundër ndryshimeve ligjore që i japin fuqi Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe prokurores se përkohshme Arta Marku, për të emëruar gjyqtarët dhe prokuroret e rinj, në kushtet kur KLGJ dhe KLP ende nuk janë ngritur. "Nuk mund të pranoj që në emër të kësaj reforme, të kthehemi përsëri 180 gradë mbrapa, të kthehemi te këta anëtarë të KLD apo dhe Prokurori i Përgjithshëm i përkohshëm që e sollën për dy muaj, por po vazhdon të bëjë emërimet vetë, nuk mund të flasim për Këshillin e Prokurorisë, i cili ka qenë inekzistent",-deklaroi deputeti i LSI-së Nasip Naço. Partia Socialiste, me mbështetjen e misioneve të EURALIUS dhe OBDAT propozoi që për dy vite emërimet e magjistratëve t'i bëjë KLD dhe Prokurori i Përgjithshëm. Socialisti Ulsi Manja u shpreh: "Do të ndiqet një parim i meritës së studentëve apo kandidatëve magjistratë në emërimin që do të bëjë Këshilli i Lartë i Drejtësisë, ky aktuali që është, jemi para kësaj situate dhe kjo qe një nga arsyet që ne e propozuam nismën". Ky ndryshim ligjor kërkon 84 vota në parlament dhe socialistët nuk i kanë votat për ta kaluar. PD është kundër dhe nuk merr pjesë në Komisione për shkak të çështjes Xhafaj, ndaj Partia Socialiste do tentojë konsensusin e LSI-së dhe e ka shtyrë miratimin e ligjit nen për nen. Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Partia Socialiste, në Komisionin e Ligjeve ranë dakord është që Shkolla e Magjistraturës të mund të pranojë deri në 50 studentë të rinj në muajin shtator.

### Kreu i KLSH: Kuvendi të zbatojë rekomandimet

## Abuzimet, Leskaj: Problem largimi i zyrtarëve të konstatuar me shkelje



**GRAMOZ RUCI**
"Rekomandimet apo propozimet për penalizime ndaj shkeljeve e shkelësve të ligjit nuk do ta kenë të lehtë të fshihen apo zvarriten pas teknikaliteteve e justifikimeve të burokratëve përgjegjës",-tha z.Ruçi.

Kontrolli i Lartë i Shtetit i bëri dje thirrje Kuvendit që të ndjekë me kujdes rekomandimet e bëra për institucionet dhe sidomos ato që lidhen me largimin e zyrtarëve të korruptuar. Kreu i KLSH Bujar Leskaj duke folur gjatë prezantimit të strategjisë 2018-2020 kërkoi miratimin sa më parë të nënkomisionit që do të ndjekë zbatimin e rekomandimeve. Kreu i Kuvendit Gramoz Ruçi premtoi se do ta miratojë sa më parë ngritjen e nënkomisionit parlamentar për çështjet e KLSH. Rekomandimet e bëra nga KLSH në lidhje me abuzimet e konstatuara nga auditimet nuk zbatohen nga institucionet dhe sidomos kur flitet për largimin e zyrtarëve të konstatuar me shkelje. Ky shqetësim u ngrit gjatë aktivitetit ku u prezantua strategjia për zhvillimin e KLSH-së 2018-2020. "Kusht të ulët kemi vetëm zbatimin e rekomandimeve për largimin e zyrtarëve të lartë nga detyra kur konfirmohet nga auditet e KLSH që ata kanë kryer shkelje në punën e tyre",-theksoi z.Leskaj. Kreu i Kontrollit të lartë të Shtetit i kërkoi kreut të Kuvendit Gramoz Ruçi që Kuvendi të rrisë rolin e tij kontrollues për zbatimin e rekomandimeve. "Kemi gjetur mbështetjen e Kuvendit, por kuptohet që për rezultatet të gjithë duhet të bëjmë shumë. Angazhim juridik që kërkojmë ne nga qeveria e Shqipërisë, nxjerrja e një urdhri nga kryeministri për zbatimin e rekomandimeve të KLSH",-tha z.Leskaj. Kryeparlamentari Gramoz Ruçi premtoi se gjetjet e auditimeve dhe rekomandimet e KLSH do të kalojnë nëpërmjet një procesi të gjerë shqyrtimi e llogaridhënieje. Ai tha se shumë shpejt do të miratojë ngritjen e nënkomisionit parlamentar për çështjet e KLSH.

## Të rinjtë e FRPD dhe LRI protestë para Ministrisë së Brendshme: Xhafaj ik

Të rinjtë demokratë dhe të LRI protestuan sërish dje para Ministrisë së Brendshme duke kërkuar largimin e Fatmir Xhafajt. Kjo është protesta e dytë e të rinjve të dy partive opozitare brenda javës, ndërsa vjen pas asaj të 26 majit në bulevard. Ashtu sikur ndodhi edhe javën e parë, në protestë nuk munguan simbolika si "lekët e drogës" apo "qeset me kokainë", ndërsa të rinjtë opozitarë ironizuan me një 'ekspozitë' me faqet e para të disa mediave ndërkombëtare që flasin për Shqipërinë dhe drogën. "Integrimi i vendit mbahet peng nga Rama dhe Xhafaj. Ministri i Brendshëm duhet që të largohet. Kuksianët janë në burg, ndërsa Tahiri është i lirë. Protesta do të vijojë këtu, por edhe javës tjetër në Kukës kundër tarifës së rrugës",-deklaroi kreu I FRPD Belind Këlliçi. Opozita kërkon dorëheqjen e Xhafajt duke e akuzuar se mbrojti vëllanë e dënuar në Itali për trafik droge, ndërsa pak javë më parë publikuan edhe një përgjim misterioz ku ngrinin pretendimet se Agron Xhafaj vijonte trafikun e drogës në Shqipëri. Vëllain i ministrit është dorëzuar në Itali, ndërsa përgjimi misterioz është dërguar në Romë për ekspertizë, dëshmitari 'X' i njohur si 'Babalja' ka kërkuar azil politik në Kosovë.



## Droga, denoncimi te Berisha për vëllain e kryebashkiakut Bushi

Ish-kryeministri Sali Berisha publikoi dje mesazhin që i vjen nga një qytetar dixhital, ku ky i fundit denoncon sjelljen e policisë. Sipas Berishës, policia po bën korrje selektive të arave të kanabisit. Ndërkohë, qytetari i shkruan Berishës se pas parcelave me kanabis të prerë në Zallë të Fushë-Krujës fshihet si pronar kryeplaku Ilirjan Sala, Ilir Bushi, vëllai i kryetarit të bashkisë Krujë Artur Bushi, si dhe punonjësi i policisë, Betim Rryci. Po dje ish-kryeministri përmes një statusi në 'Facebook' shkruan se kreu i qeverisë ka urdhëruar vendosjen e shamive të kuqe që mbanin dikur pionierët gjatë regjimit komunist. Një rast i tillë sipas Berishës ka ndodhur në gjimnazin 'Havzi Nela' në Kukës.



Sherri te "Mediat", akuzat për protestat e 26 majit 2018 dhe 21 janarit 2011

# Debati i plotë në komision, Ylli: Ju vratë, Boçi: Ti gëzove

## "Halabak, legen, langaraq", përplasja mes deputetëve



Valentina Madani

Deputetët e mazhorancës dhe të opozitës debatuan ashpër dje në Komisionin e Medias ku ishte parashikuar seanca dëgjimore me gazetarin, Bledi Kasmi. Opozita akuzoi se u ushtrua dhunë ndaj protestuesve në 26 maj para Ministrisë së Brendshme, ndërkaq mazhoranca risolli në vëmendje katër protestuesit e vrarë më 21 janar 2011 para Kryeministrisë. Akuzave të ndërsjella mes deputetëve në komision ia lanë vendin fyerjet. Tensioni shoqëroi jo pak edhe kryetaren e komisionit, Albana Vokshin, së cilës iu desh të mbante nën kontroll edhe deputetët e saj. Demokratët u shprehën se policia ka dhunuar Kasmin në protestën e 26 majit para Ministrisë së Brendshme, ndërsa socialistët kanë risjellë në vëmendje 21 janarin ku u vranë 4 protestues. Por me foto të 21 janarit në duar, deputeti socialist Fidel Ylli donte të tregonte se Kasmi thjesht po viktimizohej e ishte nga ata gazetarë që në 21 janar të 2011-ës i quajti puçistë kolegët e tij që bënin detyrën. Pikërisht kjo acaroi demokratët në komision, të cilët nga ana tjetër akuzuan kryeministrin Edi Rama se ushtroi dhunë në protestën e 26 majit. Pas raportimit të Kasmit, deputeti socialist, Fidel Ylli kërkoi fjalën, por Vokshi i kërkoi të priste radhën. Ylli përmendi protestën e 21 janarit ku siç tha ai u plagos një gazetar, ndërsa katër kolegë të tjerë të tij u shpallën nga Sali Berisha puçistë pse ndodheshin në ambientet e një kafeje përballë Kryeministrisë. Por i menjëhershëm ishte reagimi i Luçiano Boçit dhe gjatë debatit me Fidel Yllin ata i drejtohen njëri-tjetrit me fjalët 'rrugaç', 'halabak' dhe 'ordiner'. Por sipas tij, ndonëse ishte pa mikrofon ai iu përgjigj me të "njëjtën monedhë" socialistit Fidel Ylli, i cili sipas tij kishte ardhur të bënte të fortin dhe kishte një skenar të qartë të parapërgatitur. "Në momentin që ai na etiketoi jeni vrasës, nuk durova dot, aty kundërshtia ime ishte e fortë. Ia ktheva duke thënë se jeni ju të tillë, por nuk e priti mirë. Më erdhi keq që isha pa mikrofon. Ai mori pozicionin e të fortit, e ndjen vetën shumë të fuqishëm dhe për të këto mund të cilësohen si gjëra të zakonshme",- tha Boçi. Demokrati tha se e gjithë kjo situatë u krijua për të shmangur vëmendjen nga çështja. "Ishte i parapërgatitur ai, kishte ardhur me kopjen e gazetës, iu referua gazetës për të nervozuar mbledhjen për ta nxjerrë nga fokusi",- deklaroi z.Boci.

**DËSHMIA**

Me fashë në kokë, kryeredaktori i RD-së, Bledi Kasmi, dje dha dëshminë e tij para Komisionit të Medias për dhunën në protestën e opozitës. Duke iu përgjigjur deputetëve të PS-së, ai u shpreh se nuk ka goditur asnjë efektiv, dhe se për të kuptuar të gjithë ngjarjen duhen të gjitha pamjet dhe jo vetëm një sekuencë, duke theksuar dhe një herë se ishte duke kryer detyrën. "Nuk kishte zgjidhje tjetër përveçse të vetëmbrohej. Një nga këto zgjedhje ishte dhe ajo që zgjidha unë, të vetëmbrohesha, duke vendosur duart tek bandiera e hekurt dhe duke moslejuar precipitimin e dhunës së mëtejshme. Dua t'ju kujtoj edhe nga fotografitë, janë shumë gazetarë që kanë qenë në vijën e parë dhe nuk e di pse shkopi i hekurt më përzgjidhi vetëm mua. Janë fotografitë që tregojnë që gazetaret ishin mes protestuesve. Në këto kushte është detyrë e gazetarëve që të ndodhen aty ku ndodh lajmi. Në spital më ka ardhur drejtori i policisë, zoti Veliu, më ka vizituar dhe është mirëpritur nga ana ime dhe familjarët e mi. E mora mesazhin e drejtorit si një ndërhyrje për të arritur një lloj paqtimi për atë që kishte ndodhur. Zotëria më tha që kishte ardhur për situatën shëndetësore. Në ato momente i shpjegova se u godita nga një shkop gome shumë i fortë. Ka ndërhyrë dhe më ka thënë që shkopi i gomës nuk shkakton çarje në kokë. Aty e kuptova se vizita e tij nuk kishte qëllim që të dënonte dhunën dhe të distancohej, por kishte si qëllim të manipulimit të së vërtetës",-tha z.Kasmi. Deputetët e opozitës do të depozitojnë në Kuvend një draft rezolutë për dhunën ndaj gazetarëve. Kryetarja e Komisionit të Medias, Albana Vokshi i bëri thirrje edhe mazhorancës që të bashkohen me opozitën në këtë nismë.



Mbledhja e djeshme e Komisionit Parlamentar të Medias

### NGA PUÇISTËT TE FOTOJA NË DUAR, DEBATI I PLOTË NË KOMISIONIN E MEDIAS

**FIDEL YLLI:** Kam 40 minuta që dëgjoj dhe nuk ndërhyra, tani dua fjalën. A ka mundësi të flas?
**ALBANA VOKSHI:** Ule zërin, ti mua nuk më bërtet. Distancohuni nga dhuna, e ka thënë edhe BE. Keni 24 ditë kohë, këshillojeni kryeministrin që të fillojë dhe të plotësojë kriteret, të mos ushtrojë dhunë, të mos mbyll portalet, distancohuni nga dhuna.
**FIDEL YLLI:** Berisha shpalli puçistë katër gazetarë dhe i thirri në komision dhe hyri në lokal dhe i nxori me dhunë.
**ALBANA VOKSHI:** Ore po turp i madh, ai është me kokën e çarë ju vazhdoni akoma fajin e ka Saliu? Ça po thua, i ra gurit me kokë?
**EDMOND SPAHO:** Protestat tona në dallim nga tuajat janë brenda limiteve politike. Por natyrisht ka një moment kur policia provokon dhe njerëzit reagojnë si në këtë rastin e Partia Demokratike u tregua forcë e përgjegjshme. Deputetët e saj, e keni në të gjithë regjistrimet, kanë dalë në krah të policisë dhe kanë qetësuar njerëzit. Ky është dallimi i madh midis nesh dhe jush dhe më pas, dallimi midis Edi Ramës dhe Lulzim Bashës: Ndërsa Edi Rama i nxiste me telefon nga kullat e tua Fidel, Lulzim Basha erdhi i tërhoqi njerëzit dhe i çoi tek PD-ja,"
**FIDEL YLLI:** Ju vratë 4 veta në bulevard futët në burg gazetarë, ca i larguat në azil dhe vini tani me një gazetar anëtar partie që bën viktimën këtu. Ky gazetar është viktimë jo gazetar i medias së lirë.
**NDËRHYN LUÇIANO BOÇI:** Mbylle gojën!
**FIDEL YLLI:** Ik ore lëngaraq, u bëre ti të më ndërpresësh fjalën
**LUÇIANO BOÇI:** Langaraq je ti!
**ALBANA VOKSHI:** Qetësi!
**LUÇIANO BOÇI:** Mbylle gojën!
**FIDEL YLLI:** Gojën mbylle ti…katër vrasje qeveria jote, katër, katër
**LUÇIANO BOÇI:** I vetmi që është gëzuar me ato katër vrasje ka qenë Edi Rama, legen!
**FIDEL YLLI:** Legen je ti, lëngaraq, halabak, je rrugaç, kryerrugaç dhe ordiner!
**LUÇIANO BOÇI:** Rrugaç je ti që ju pret fjalën kolegëve këtu, që nuk respekton radhën
**ALBANA VOKSHI:** E shara dhe e fyera…
**ALBANA VOKSHI:** O Boç pusho ti tani…s'ka gjë se jam unë me mikrofon
**LUÇIANO BOÇI VAZHDON DEBATIN ME YLLIN:** Si të dua unë do flas
**FADIL NASUFI-VOKSHIT:** Pse ja jep fjalën atij, ça tagri ka ai këtu (Për Fidel Yllin)
**FIDEL YLLI:** Shife, shife ku e ka telefonin, vetëm gazetar nuk është ai. Ai është agresor. Të shkojë të gjejë atë që i ka rënë në kokë, të shkojë në prokurori. Është ky që sot viktimizohet krijon dhunë, shkon shkul hekura e godet policinë. I thoshte puçist Mero Bazes dhe gazetarëve të tjerë që bënin opozitë me 21 janar. (I referohet një shkrimi të RD)
**ALBANA VOKSHI:** Na e sqaro pak këtë me puçistët dhe a ke ushtruar dhunë ti në protestë?
**BLEDI KASMI:** Të sqaroj titullin e RD: Dështimi i puçistëve. Ishte 21 janari, sulmi ndaj kryeministrisë. 21 janari kishte si qëllim të shkelnin mbi trupa e kufoma për të marrë pushtetin. Shkrimi s'ka lidhje fare me gazetarët, nuk di të jetë dhunuar ndonjë gazetar në 21 janar. Në pamje ju keni vetëm një sekuencë kur ndodhem unë aty, tre minuta më parë, s'keni rënien pa ndjenja të një 64-vjeçari, ku e keni mund ta tregoni këtu. Mos mendoni që do shtriheshim si dele në rruge...më fluturuan syzet ku të gjeja kartë unë t'ia tregoja atij policit që erdhi nga rreshti i dytë dhe më sulmoi. Sulmi na detyroi të vetëmbroheshim. Unë uroj të mos jeni asnjëherë në ato rrethana.

**PËRPLASJA**

Akuzave të ndërsjella mes deputetëve në komision ia lanë vendin fyerjet. Tensioni shoqëroi jo pak edhe kryetaren e komisionit, Albana Vokshin, të cilës iu desh të mbante nën kontroll edhe deputetët e saj. Demokratët u shprehën se policia ka dhunuar Kasmin në protestën e 26 majit para Ministrisë së Brendshme, ndërsa socialistët risollën në vëmendje 21 janarin ku u vranë 4 protestues.

### "Mazhoranca e mbushur me vrasës"

## Akuzat, Spaho: Rama më 21 janar nxiste dhunën me celular

Pas debatit të zhvilluar dje në Komisionin e Medias, ku u diskutua dhuna ndaj kryeredaktorit të gazetës "Rilindja Demokratike", Bledi Kasmi, ka reaguar kreu i grupit parlamentar Edmond Spaho. Në fjalën e tij ai ka bërë krahasimin e Ramës me Bashës në protesta. Sipas Spahos, kur Rama ishte në opozitë e protestonte më 21 nxiste dhunën me celular e me shenja, kurse Basha shkoi dhe i tërhoqi njerëzit duke shmangur dhunë. "Unë desha të shpreh indinjatën dhe të hedh poshtë me përbuzje fjalorin që u përdor ndaj kolegëve të opozitës duke i quajtur "vrasës", - deklaroi Spaho. Deputeti i PD-së akuzoi se mazhoranca e sotme është e mbushur me vrasës. "Vrasësit i gjeni në tjetër drejtim, nuk janë tek opozita, as tani, as kur ka qenë në pushtet. Vrasësit i keni pasur midis jush, në parlamentin tuaj 2013-2017 madje u ndërpre çdo lloj negociate nga Komuniteti Europian për procesin e integrimit të vendit tonë, sepse kishim një mazhorancë, një qeverisje të mbushur me vrasës, me kriminelë. Kjo nuk është retorikë politike, por fakt i vërtetë. Një takëm prej këtyre e kanë lënë tashmë parlamentin, por nuk është se kanë mbaruar, ka dhe të tjerë në parlamentin aktual. Ndaj këto fjalë merrini mbrapsht! S'janë për ne, janë për ju!", u shpreh z.Spaho. Ai shtoi më tej: "Paralelja që po përpiqeni të bëni me 21 janarin është qesharake. I vratë njëherë ata, po i vrisni për herë të dytë! Keni pasur 5 vjet kohë në dispozicion për të zbardhur të vërtetën. Por e vërteta është një dhe e thjeshtë: Ishte puç kushtetues! Keni dashur të merrni pushtetin me forcë, me dhunë, keni sulmuar Kryeministrinë me të gjitha mjetet e mundshme! Ky është dallimi mes nesh dhe jush! Ne nuk e marrim pushtetin me dhunë! Protestat tona në dallim nga tuajat janë brenda limiteve politike. Por natyrisht ka një moment kur policia provokon dhe njerëzit reagojnë si në këtë rastin e Partia Demokratike u tregua forcë e përgjegjshme. Deputetët e saj, e keni në të gjithë regjistrimet, kanë dalë në krah të policisë dhe kanë qetësuar njerëzit. Ky është dallimi i madh midis nesh dhe jush dhe më pas, dallimi midis Edi Ramës dhe Lulzim Bashës: Ndërsa Edi Rama i nxiste me telefon nga kullat e tua Fidel, Lulzim Basha erdhi i tërhoqi njerëzit dhe i çoi tek PD-ja," tha z.Spaho.

**VETINGU**
**VENDIMI**

Kandidatja për në Këshillin e Lartë Gjyqësor, ja pasuria që zotëron

# Vetingu, konfirmohet në detyrë gjyqtarja Marçela Shehu

## *KPK: Nuk ka shkelje dhe fshehje të pasurisë*

Ina Allkanjari





Gjyqtarja e Gjykatës së Kurbinit, Marçela Shehu

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit rikonfirmoi ditën e djeshme në detyrë gjyqtaren e Gjykatës së Kurbinit, Marçela Shehu. Gjyqtarja e Kurbinit, njëherësh kandidate për Këshillin e Lartë Gjyqësor, doli "e pastër" nga vetingu. Më 1 qershor, KPK zhvilloi seancën dëgjimore me Shehun dhe e njohu gjyqtaren me rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit. Sipas Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë, pasuria e Shehut është e justifikuar. Trupa e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit e përbërë nga Brunilda Bekteshi, Lulzim Hamitaj dhe Olsi Komici u shprehën se nga verifikimi i ILDKPKI dhe i vetë komisionit ka rezultuar se gjyqtarja nuk ka shkelje dhe fshehje të pasurisë. Në seancë dëgjimore publike, Shehu mësoi se në të tria shtyllat e procesit të rivlerësimit pasuria, figura morale dhe aftësitë profesionale rezultonte pa probleme. Gjyqtarja rezulton se ka një apartament, një makinë dhe depozitë kursimi. "ILDKPI për gjyqtaren ka dorëzuar raportin me konstatim se është deklarim i saktë pasurie dhe e ka të justifikuar. Ne bëmë verifikim të thelluar, ka deklaruar shtëpi banimi 100m2 në njësi bashkiake nr. 8 në Tiranë, veturë 'Mercedez Benz' blerë në 2016 me vlerë 6 mijë euro, para kesh 1 milion e 350 mijë lekë dhe depozitë kursimi në emrin e fëmijëve me vlerë nga 100 mijë lekë secila. DSIK për sa i përket figurës ka sjellë raport ku shprehet se gjyqtarja nuk ka shkelje dhe është e përshtatshme për të vazhduar detyrën", u shpreh Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Marçela Shehu ka gjasë të renditet e katërta në listën me gjykatës e prokurorë, të cilët deri më tani kanë mundur t'i shpëtojnë rrjetës së vetingut. Marçela Shehu u bë pjesë e sistemit gjyqësor 12 vite më parë. Pas përfundimit të shkollës së Magjistraturës, punoi fillimisht në gjykatën e Tiranës e më pas u transferua në Kurbin. Gjyqtarja e Kurbinit është një nga 14 kandidatët për në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Para trupës gjykuese, pasi deklaroi se është dakord me gjetjet e komisionit, ajo kërkoi konfirmimin në detyrë. "Jam dakord me verifikimet nga ana e KPK-s, kërkoj të vazhdoj detyrën, procesi ka qenë korrekt", u shpreh Marçela Shehu. Ditën e djeshme pasi doli nga seanca në KKP-së, gjyqtarja është pritur jashtë nga familjarët, ndërsa i biri e ka surprizuar me një tufë lule.

**PASURIA**

Të dhënat tregojnë se gjyqtarja Marçela Shehu zotëronte një pasuri familjare prej 1.3 milionë lekësh në vitin 2006. Në fund të vitit 2016, pasuria e saj është dyfishuar, duke kapur vlerën e rreth 2.7 milionë lekëve. Pasuria familjare e zonjës Shehu ndahet në 200 mijë lekë llogari bankare, 1.5 milionë lekë kursime në kesh dhe rreth 1 milion lekë automjete. Gjyqtarja ka gjithashtu në bashkëpronësi një shtëpi private të ndërtuar në vitet 1998-2000, të cilën e ka përfituar si rrjedhojë e martesës dhe e ka deklaruar atë në vitin 2007. Të ardhurat e gjyqtares Shehu përbëhen vetëm nga paga e saj dhe ajo e bashkëshortit, të cilat kapin në total vlerën e 12.9 milionë lekëve. Përgjatë viteve në karrierë, zonja Shehu ka shënuar një rritje mesatare të pasurisë prej 133 mijë lekësh në vit.

**VENDIMI**

Gjyqtarja e Kurbinit, njëherësh kandidate për Këshillin e Lartë Gjyqësor, Marçela Shehu doli "e pastër" nga vetingu. Më 1 qershor KPK zhvilloi seancën dëgjimore me Shehun dhe e njohu gjyqtaren me rezultatet e hetimit administrativ të komisionit. Sipas Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë, pasuria e Shehut është e justifikuar.

**TË RIKONFIRMUAR NË DETYRË**

- **Vitore Tusha** - Gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese
- **Fatjona Memcaj** - Prokuroren e Apelit të Tiranës
- **Manjola Xhaxho** - Gjyqtare në Gjykatën e Tiranës
- **Marçela Shehu** - Gjyqtare në Gjykatën e Kurbinit

## Vetingu, në 'sitë' prokurorja Anila Leka. KPK: Justifikon pasurinë, e aftë profesionalisht



Prokurore e Prokurorisë së Përgjithshme, Anila Leka

Një tjetër prokurore kaloi ditën e djeshme në 'sitën' e vetingut. Para Komisionit të Pavarur të Kualifikimit doli Anila Leka, prokurore e Prokurorisë së Përgjithshme dhe kandidate për Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Leka pritet të rikonfirmohet në detyrë, pasi KPK konkludoi se prokurorja justifikon pasurinë dhe është e aftë profesionalisht. "ILDKPKI ka sjellë raport për Anila Lekën për deklarim të saktë, pasuri të justifikuar, nuk ka deklarim të rremë. Pas kësaj bëmë hetim të thelluar. Leka ka apartament në Tiranë me sipërfaqe 91 m2, apartament në Golem 74 m2 me vlerë 3 milionë lekë, llogari bankare, bono thesari, gjendje kesh 11 mijë e 500 dollarë. I ati i prokurores ka 7500 dollarë, ndërsa e ëma 9000 dollarë gjendje kesh nga dëmshpërblimi si ish-të dënuar politikë", thuhet në raportin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Mësohet se vendimi final për Anila Lekën do të jepet më 6 qershor. Anila Leka doli para KPK, organit të bazë të vetingut, për t'u njohur me rezultatet e hetimit të thelluar për ligjshmërinë e pasurisë, kontaktet e mundshme me botën e krimit dhe aftësitë profesionale. Ndërkohë, zbulohet pasuria e deklaruar e prokurores Leka nga viti 2004 deri në fund të vitit 2016. Ky raport është prodhuar pas administrimit të deklaratave të pasurisë së këtij subjekti nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrolli të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, ILDKPKI. Ai ka për qëllim bërjen e transparencës mbi pasurinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve që i nënshtrohen procesit të vetingut. Të dhënat e analizuara tregojnë që prokurorja e organit qendror të akuzës, Anila Leka zotëronte një pasuri familjare në vlerën e rreth 4 milionë lekë në vitin 2004. Në fund të vitit 2016, pasuria e saj rezulton të jetë 10.4 milionë lekë ose 2.6 herë më e lartë se viti fillestar. Të ardhurat kryesore të zonjës Leka përbëhen më shumë se 96 për qind nga paga prej funksionit. Të ardhurat nga interesat bankare përfaqësojnë 3.6 për qind të të ardhurave, të cilat kapin vlerën totale 21.5 milionë lekëve në 13 vitet e analizuara. Asetet e zonjës Leka në fund të vitit 2016 ndahen në 6.2 milionë lekë në pasuri të paluajtshme, rreth 576 mijë lekë në kursime kesh dhe 3.6 milionë lekë në likuiditetet bankare.

**KONSTATIMI**

"Anila Leka ka apartament në Tiranë me sipërfaqe 91 m2, apartament në Golem 74 m2 me vlerë 3 milionë lekë, llogari bankare, bono thesari, gjendje kesh 11 mijë e 500 dollarë. I ati i prokurores ka 7500 dollarë, ndërsa e ëma 9000 dollarë gjendje kesh nga dëmshpërblimi si ish-të dënuar politikë", thuhet në raportin e KPK.

HIPOTEKA
CERTIFIKATAT

Certifikatat e pronësisë në të gjitha zonat e Tiranës

# Hipoteka, 250 certifikata pronësie në Tiranë

## Ndërtuan pa leje, pronarët marrin tapitë

Ornela Manjani

Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme publikon listën e 250 personave që marrin edhe certifikatën e pronësisë, pasi janë pajisur me leje legalizimi. Këtyre familjeve, banorë të qarkut Tiranë, u jepet në dorë hipoteka e pronës, duke përmbyllur kështu një cikël të gjatë e të shumëpritur. Procedurat për marrjen e tapisë janë ndjekur nga ALUIZNI, i cili ka dorëzuar dosjet në hipotekë, por përfituesit duhet të shkojnë vetë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive Tiranë të kryejnë aplikimin për tapitë. ALUIZNI dorëzon në ZRRP verifikimin e gjendjes juridike të pronës ku janë ngritur ndërtimet informale, përditësimin e regjistrit të pasurive të paluajtshme, kartelave dhe hartave kadastrale, sipas blloqeve kadastralë ku janë ngritur ndërtimet informale dhe regjistrimin e lejes së legalizimit dhe të pasurisë së legalizuar. ZRPP fton qytetarët, që lexojnë emrat në listën e mëposhtme, të paraqiten pranë zyrave të Hipotekës.

**PROCEDURA**

ALUIZNI dorëzon në ZRRP verifikimin e gjendjes juridike të pronës ku janë ngritur ndërtimet informale, përditësimin e regjistrit të pasurive të paluajtshme, kartelave dhe hartave kadastrale, sipas blloqeve kadastralë ku janë ngritur ndërtimet informale dhe regjistrimin e lejes së legalizimit dhe të pasurisë së legalizuar.

### LISTA E 250 PERSONAVE QË MARRIN EDHE CERTIFIKATËN E PRONËSISË

| NR | EMER ATESI MBIEMER |
|---|---|
| 1 | SHABAN XHEMAL HIDRI |
| 2 | ASTRIT FUAT MOLLAYMERI |
| 3 | XHAFERR HAMDI CURRI |
| 4 | ORLIND SELIM VELI |
| 5 | LAVDRIM AGIM RASKA |
| 6 | SPIRO FADIL FILANGJI |
| 7 | MIMOZA FATMIR GRACARI |
| 8 | BALKIZE SEFULLAH KALICANI ; ERMIRA XHEMIL SIMAKU ; FATOS XHEMIL KALICANI ; SHABAN XHEMIL KALICANI |
| 9 | VEBI SULEJMAN DISHA |
| 10 | YLLI SABRI DEMIRI |
| 11 | ASTRIT FADIL ISMAILI |
| 12 | KUJTIM VESEL GERDECI |
| 13 | RASIM QERIM BRATI |
| 14 | ELVER ABAZ TELUSHI |
| 15 | LUMTURIJE FRROK PRENDI ; SEFERIN FRANG PRENDI |
| 16 | FREDI DEMIR XHAFERAJ |
| 17 | AFRIM QAZIM MERRA |
| 18 | AGRON NDUE VUKZAJ |
| 19 | ARBEN BAJRAM BRAHIMI |
| 20 | JANI ADEM KOTARJA |
| 21 | GEZIM ABDULLA HAKBALLA |
| 22 | FESTIM BARI MECI |
| 23 | RIZA FADIL LILA |
| 24 | XHEVAT DAMAN NELI |
| 25 | OGUR MAHMUT KELI ; EMILIANO MEHMET KELI |
| 26 | FADIL TAHIR MUCAJ |
| 27 | PREL DED ZMALI |
| 28 | ARETI NIKOLL HILA |
| 29 | ISMAIL ASLLAN KOLECI |
| 30 | ILIR VEHBI TOTA |
| 31 | RIFAT XHEVAHIR DISHA |
| 32 | HAXHI ABDULLA GEGA |
| 33 | KUJTIM HAMDI BRARI |
| 34 | BAJRAM DALIP SALIA |
| 35 | FATJON HUMAN FIDA |
| 36 | XHEMIL MUHAMET VALIKAJ |
| 37 | JOSIF JORGJI PIHIJONI |
| 38 | NDREU STAVRI CEREPI |
| 39 | EDLIRA KUJTIM LLOHA |
| 40 | BAKI SELIM MEMLIKA |
| 41 | ARSEN SARIQ AGO |
| 42 | GEZIM AVNI LUTAJ |
| 43 | BUJAR BASHKIM KODRA |
| 44 | SAFET MUHARREM SHKEMBI |
| 45 | RAMAZAN HYSNI VOGLI |
| 46 | MURAT GANI ALLUSHI |
| 47 | NEXHAT MENDU HOXHA |
| 48 | ADHURIM SEIT DAUTAJ |
| 49 | SOKOL ZEF KOLBUCAJ |
| 50 | DHIMITER KOCO GJOKA |
| 51 | MUSA HAMDI KACANI |
| 52 | MURAT ISMAIL KORE |
| 53 | QAMILE XHEMAL PREGJA |
| 54 | ASTRIT AHMET MUSLIA |
| 55 | LAUREND ASLLAN SPAHIU |
| 56 | REZART LUAN PALLA |
| 57 | KRISTINA KLEANTHI NASKA |
| 58 | BESNIK FERIT DANI |
| 59 | ARJAN FERIK CULLHAJ |
| 60 | FAIK XHETAN LACI |
| 61 | FESTIM RITVAN STAFA |
| 62 | MURAT QAMIL SULA |
| 63 | EDUART ZAKE BREGASI |
| 64 | ROLAND TAHIR DELIU |
| 65 | HAMZA QAZIM HIDA |
| 66 | FIQIRI MALIQ HIDA |
| 67 | EDMOND FAZLLI DEMOLLARI |
| 68 | NAIM KADRI XHIXHA |
| 69 | NEBI BEHXHET KODRA ; QAZIM BEHXHET KODRA |
| 70 | LAUD RAMAZAN SIPRI |
| 71 | ALUSH MALIQ KOCI |
| 72 | NIMAN UKE NEZA |
| 73 | RAMAZAN ALI ADEMAJ |
| 74 | HEKTOR JANI HARISIS |
| 75 | ALTIN EQEREM KALANXHI |
| 76 | BILBIL MARASH MARKU |
| 77 | MAJLINDA VANGJEL SIMONI |
| 78 | ERMAL BASHKIM TOSKA |
| 79 | FATBARDHA QAZIM MARKU |
| 80 | VESEL MURAT MZIU |
| 81 | SKENDER SEID KORRIKU |
| 82 | PIRO ENDREA ZOTO |
| 83 | FATMIR HYSEN SHUPLI |
| 84 | ASTRIT RRUZHDI SHEHU |
| 85 | FRANKLIN DHIMOSTEN MALO |
| 86 | ASTRIT HASAN KOKOSHI |
| 87 | MEHMET HAJRO ZENELI |
| 88 | HYSEN XHELAL REMA / JORGO HYSEN ILIAS |
| 89 | BARDHYL MERSIN HOXHOLLI |
| 90 | RAHMAN HAXHI XHAFA |
| 91 | LUAN DEMIR OSMANI |
| 92 | SULEJMAN ABDYL KAZIU |
| 93 | ARBEN MAL KATROSHI |
| 94 | HAXHI SADIK GJANA |
| 95 | ALBAN IRAKLI NITO |
| 96 | ZENEL BESIM SINA |
| 97 | KORAP QAMIL MUCA |
| 98 | FIQIRI CELNIK ZENUNLLARI |
| 99 | BURAN NASIBI LAMCE |
| 100 | ENKELEJD RAMADAN MEMINAJ |
| 101 | SELMAN ALI MOKRA |
| 102 | RUDIN SHEFQET GJOSHI/ YLBER SHEFQET GJOSHI |
| 103 | KUJTIM REXHEP BYBERI |
| 104 | MEXHIT HYSEN STAFA |
| 105 | PETRIT SALI DEMA |
| 106 | LINDITA ASTRIT TROJA |
| 107 | GJERGJ PETRAQ BICOLLI |
| 108 | HAXHI ALUSH RRAHMANI |
| 109 | FEZULLA ADEM MEREPEZA |
| 110 | BAJRAM SADIK LIKA |
| 111 | NAIM ENVER AVDIA |
| 112 | HAXHI MUHARREM SALLAKU |
| 113 | ALI NEVRUZ PODA |
| 114 | GEZIM PJETER ZEFI |
| 115 | NEVRUZ HAXHI BICI |
| 116 | BLEDAR RIFAT HOTI |
| 117 | QAMIL JONUZ MISKU |
| 118 | SABRI ALI MULKURTI |
| 119 | SHKURT EMERLLA IBRALIU |
| 120 | FERIT JAKUP KULLI |
| 121 | REFAT AHMET MUSTEQJA |
| 122 | MENTOR SHAZIMAN SHUTINA |
| 123 | GANI MUHAMET FEJZAJ |
| 124 | SHABAN YMER HURDHA |
| 125 | ABAS SHEFQET THANA |
| 126 | VASIL ALEKS MARIANI |
| 127 | HAJDAR ALI LLABANI |
| 128 | ABAS ZIFKO HYSENI |
| 129 | ANGJELINA QATIP MURATI / ERVIN QATIP MURATI / JONIDA QATIP MURATI / XHEVRIE ABDURAHMAN MURATI |
| 130 | ARSEN RIZA KAZA / SELAJDIN RIZA KAZA |
| 131 | JETMIRA HASAN TALE |
| 132 | BASHKIM MUHARREM GJOKMELI |
| 133 | FATMIR SHABAN XHAFA |
| 134 | DRITAN HAKI ALIU |
| 135 | ARJAN/ EDMOND / KUJTIM MEHMET LINXA ; MYZEJEN MEHMET ULQINAKU |
| 136 | SHPETIM GANI BASHA |
| 137 | BAJAME MUHAREM MEMAJ ; EGLANTINA BEDRI MEMAJ; ILIRJAN ELMAZ MEMAJ |
| 138 | HYSNI BAJRAM META |
| 139 | BESNIK ENVER NOZLLI |
| 140 | KADRI LIVAN RRODHE |
| 141 | SOKOL SINAN KOLDASHI |
| 142 | MANUSHAQE; RRAHMAN MEHMET BEQIRI |
| 143 | ALBAN ARBEN LAMI; BUJAR FADIL LAMI; FLORIJE HALIT LAMI; KLODIAN ARBEN LAMI; LUMTURI OSMAN LAMI; OLTA ARBEN LAMI |
| 144 | LULZIM RAMAZAN HYKA |
| 145 | KASTRIOT SELAM HASANAJ |
| 146 | CELNIK ILIAZ MURATAJ |
| 147 | BUJAR SHYQERI JOCA |
| 148 | MAHIR XHEVDET BRIHMANI |
| 149 | GRAMOS SELIM HAMETAJ |
| 150 | ASTRIT NISHAT SALIAJ |
| 151 | BESIM AHMET MUSTEQJA |
| 152 | ARJAN , JUANA , JUELA HYSEN HODAJ; NAILE MANXHAR HODAJ |
| 153 | QAMIL MYFTAR DAKU |
| 154 | QERIM QAMIL MEMA |
| 155 | FEIM KADRI KANANI |
| 156 | KURT OSMAN SHKRETA |
| 157 | PETRIT MUSTAFA KUKLI |
| 158 | NDOC MARK IMERAJ |
| 159 | RESHIT SHYQYRI HASKASA |
| 160 | RAMAZAN RIZA NIKOLLA |
| 161 | ASTRIT TAHIR CELMETA |
| 162 | AGIM HYSEN HASLIKA |
Në shekullin e XIX institucionet hidropatike evoluan në ndërmarrje, në hotele, në SPA (llixha), në banja rekreative me mbikëqyrje nga personeli mjekësor. Në Gjermani, Francë, SHBA, Britaninë e Madhe pati shumëzim të qendrave hidropatike. Disa miliona njerëz në këto vende kalojnë kohë në banja. Në vitin 1891 Mark Twain trajtohet në Europë në banjë të ftohtë dhe zbuti reumatizmin e tij. Dr.James Willson dhe Dr.James Manby Gully hapën 2 klinika të mjekimit me ujë në Malvern, ku mjekohen pacientët e famshëm Charles Darvin, Charles Dikens, Thomas Carlyle, Florence Nichtingale, Lord Tenyson. Mjekët këshillojnë të mos shkohet në banjë para majit dhe pas tetorit. Amerikanët preferojnë muajt e verës. Koha më e mirë është korrik-gusht.

Në vitin 1860-1870, në Berlin dhe Bazel u aplikuan dushe me ujë të ftohtë në mjekimin e tifos abdominale. Në luftën franko-gjermane, dushi ftohë i kombinuar me kininë u përdor në hiperpireksi në përmasa të mëdha.

Në SHBA, në kulmin e saj kanë qenë 200 qendra hydroterapie, më të vendosura në verilindje, duke përfshire institucionet Scott, Elmira, Clifton, Springs dhe Dansville. Në Europë numërohen 1000 qendra hydroterapie. Ne Bad Worshofen ka pishina të bukura, klinika, hotele, madje edhe një pyll ku ju mund të hiqni këpucët, çorapet dhe të ecni zbathur në ujë çdo mëngjes verës dhe në dimër dhe kur ka dëborë në terren. Nëse jeni me fat mjaftueshëm për të jetuar pranë detit, ose pranë një përroi, të dyja janë ideale. Para Luftës së Dytë Botërore terapia e ujit është përdorur për terapinë e alkoolizmit ndërsa në mjekësinë moderne për terapinë e drogës.

Sebastian Kneipp (1821-1887 ) – prift bavarez. Në vitin 1855 Kneipp u dërgua në fshatin e vogël bavarez të Worshofen për të ndihmuar një manastir grash domenikane. Ai vuante nga tuberkulozi. Në këtë fshat gjeti një pus në gjendje natyrale ku mjekoheshin me ujë të ftohtë të sëmurë. Ky u quajt kura mrekulli, ku mjekoheshin një numër në rritje të sëmurësh, qe ose nuk kishin para të mjaftueshme për të paguar kujdesin mjekësor, ose iu ishte dhënë si e pashpresë nga mjekët e tyre. Kneipp ishte dërguar atje për të drejtuar jetën klerikale, për të ringjallur ekonominë në stanjacion të fshatit dhe këshilluar fermerët për të përmirësuar bujqësinë e tyre. Por, magjepse u bë për Kneipp mbizotërimi te ai shëndeti dhe shërimi i njerëzve. Ai u mësoi të sëmurëve për të trajtuar veten, gradualisht duke zhvilluar një sistem të plotë për parandalimin, kurimin dhe rehabilitimin bazuar që një qenie njerëzore është uniteti i trupit dhe shpirtit dhe sa herë që ky unitet është i kërcënuar ose sa herë harmonia e natyrës është e shqetësuar, pason sëmundje. Kompleksi i aplikimit të mjekimit me ujë nga përdorimi klasik i plakave, terapia e Knaipp u mbështet nga skema qeveritare e sigurimit shëndetësor në Europë dhe madje të subvencionuara nga shteti për shërimin dhe rehabilitimin e të sëmurëve rëndë. Kneipp, një njeri me jetë shumë të thjeshtë, por ai zotëronte një pjesë të magnetizmit personal, që krijoi besim dhe dashuri dhe i bëri njerëzit të gatshëm t'i binden atij. Me karizëm, elegancë, thjesht e natyrshëm ktheu një të vërtetë të madhe me mjete të thjeshta. Një pus me ujë të ftohtë, me një rrobë liri të ashpër, një sapllakë për të derdhur ujë, këto janë veglat e kurës me ujë të Kneipp. Mjekimi i tij me ujë kundër tuberkulozit, bindja e thellë personale, u kthye në një rekord të konsiderueshëm suksesi për pacientët që u dyndën te ky prift-mjek nga e gjithë Europa. Kneipp për trajtimin e tij përdori ujë shumë të ftohtë apo i quajtur "kurë kali" për shkak të forcës që duhej të kushtohej për të qëndruar gjatë aplikimit të procedurës.



Pusi i 'Ujit të ftohtë'

Libri i Kneipp, "My water cure" (1892) u bë bestseller dhe u përkthye në 52 gjuhë. Kneipp dëshmoi për ujin për të shëruar shumë sëmundje për shkak të fuqisë së tij për të hequr rrënjët e sëmundjes. Se uji është në gjendje të hedhë nga trupi në gjak dhe të evakuojë (nxjerr) jashtë duke pastruar organizmin dhe duke e kthyer atë nga të ligështuar në të forcuar. Kneipp përdorte vetëm metoda natyrale. Sot përdoren shumë forma që Kneipp nuk i përdorte. Sipas tij, uji vetëm shkon në lëkurë, por nuk drejtohet kundër trupit me ndonjë "forcë". Nuk kishte dushe, lavazhe. Uji sipas Kneipp paralajmëron prerazi, duhet të ngjitet nga poshtë–sipër shumë ngadalë dhe uji duhet të duket sikur e mbulon me një fletë qelqi. Qysh nga viti 1900 terapia me ujë e Kneipp është përhapur në të gjithë Europën dhe në Amerikë. Që atëherë metodat e tij janë hulumtuar, aplikuar, rafinuar dhe përshtatur nga shkencëtarët në të gjithë botën.

**PUSI UJI I FTOHTE, SHËNEPREMTE**

**Teknika:** Frekuentohet në periudhën gusht–shtator nga të sëmurë që numri i tyre është në rritje progresive kohët e fundit. Një pus i vetëm, jo i madh, futen duke pritur në radhë të sëmurë gjithë ditën. Banja vazhdon 3 ditë, zakonisht një banjë në ditë. Uji i banjës është shumë i ftohtë, 3°C. Pusi ruhet në gjendje natyrale i rrethuar me gurë. Përdoret banja e këmbëve, e gjunjëve, e baçinit (të ndenjurave) e pjesës së pasme të shpinës. Përdoren banja të ftohta të krahëve për romatizma, paraliza dhe zakonisht e gjithë trupit deri në qafë, me kokën jashtë. Zhytja në ujë bëhet shumë ngadalë, në fillim këmbët, njomen krahët dhe rrëshqitet gradualisht që uji të mos lëvizë. Njerëzit që futen njëri pas tjetrit japin sigurinë dhe këshillat përkatëse. Te koka rrinë familjaret. Kohëzgjatja e kurës dhe temperatura e banjës janë ekstreme. Me të drejtë quhet "kurë kali" nga forca dhe qëndrueshmëria që duhet për të përballuar të ftohtin, dhimbjet për një kohë të zgjatur 10 minuta, 15 minuta dhe deri 18 min. Maksimumi i kohës kur e detyrojnë të dalin nga banja. Dalja nga banja duhet bërë gradualisht pa e lëvizur ujin. Kjo quhet edhe metoda e torturës – "water torture", por quhet edhe kura mrekulli. Në banjë futet me të brendshme pambuku. Kur dilet nga banja, ndihesh i mpirë. Bëhet një vrap me kërcime në sheshin rreth pusit. Ndjen të ftohtë dhe vazhdon të mbash rroba të lagura në trup. Por është rregull i prerë: Të mos ngrohesh mbas zjarrit dhe të mos heqësh rrobat e lagura, por të futesh në një shtrat të ngrohtë me velenzë leshi si shtroje dhe si mbulesë. Dhe do të të zërë gjumi menjëherë. Kur të zgjohesh do ndihesh i lehtësuar, rrobat e lagura janë tharë. Do çuditesh vetiu se mund të ecësh më shpejt dhe më gjatë se para banjës. Do kesh dëshirë të hash apo të pish ndonjë pije, se edhe klima e panorama janë të mrekullueshme. Por vjen rregulli i dytë absolut: Nuk duhet të hash mish dhe nuk duhet të pish alkool, po i pate vënë qëllim vetes që banja të japë efektin e saj të plotë. Me këtë ndjenjë kënaqësie do bësh banjën e dytë dhe të tretë në dy ditët që vijojnë. Nëse për 10-15 ditë do ndihesh disi i lodhur, mos u shqetëso sepse janë të periudhës mbas banjës dhe pas kësaj fillon rikthimi i shëndetit, rifitimi i forcave fizike, rekreacioni, eliminimi apo zbutja e shenjave të sëmundjes.

**SËMUNDJET QË MJEKOHEN TE PUSI UJI FTOHTË**

Arthriti, osteoarthriti, arthriti rheumatoid.

Janë sëmundje me % të lartë në shkallë botërore. Ato prekin gjunjët, kockën (çapoku), kolonën vertebrale, supin, muskujt, tendinat. Bëjnë shqetësime të vazhdueshme me dhimbje të përditshme, me kufizime të lëvizjeve, të aftësisë për punë, të rëndimit në pleqëri. Janë problem të kostos së lartë të operacioneve në kyçin e gjurit, të kockës, kolonës, etj. Këta të sëmurë trajtohen nga reumatologu, ortopedi, fizioterapeuti. Vetëm nga osteoartriti vuan 5-10% e popullsisë australiane (A. Foley). I sëmuri ndjen dhimbje në gju, kufizim të lëvizjeve, shmang ngarkesën, artrofi muskulore, edem (ënjtje) e gjurit. Hydroterapia siguron një sërë përfitimesh duke përfshirë reduktimin e edemës, rritjen e volumit të lëvizjeve, lehtësimin e dhimbjeve dhe ngarkesës së reduktuar, përmirësimin e performancës personale. Shpejtësia dhe distanca e ecjes në këmbë përmirësohen ndjeshëm. Pra, hydroterapia me sukses përmirëson funksionin fizik, aftësinë e pacientit për të ecur, për të kryer aktivitete të përditshme dhe për të moshuarit, pleqtë për uljen e vdekshmërisë dhe uljen e pranimit në spitale dhe në shtëpitë e pleqve. Rritja e forcës muskulore rreth kyçit të prekur është rezultat klinikisht i rëndësishëm, meqë forca muskulore siguron rritjen e aftësisë absorbuese të goditjeve dhe përmirëson stabilitetin e përbashkët për të ndihmuar në ruajtjen e kyçit të sëmurë. Hydroterapia jep përmirësim të dukshëm në rezultatin e komponentit fizik. Ajo mund të vazhdojë me përsëritje më të larta, më të shpeshta, pra më intense. Studimet tregojnë se hydroterapia prodhon rezultate funksionale pozitive, siguron mjedis optimal për të realizuar intensitet të lartë të lëvizjeve në të sëmurë me sëmundje të kyçeve. Në banjën me ujë të ftohtë për shkak të vetive fizike të ujit si kohezioni, forca e gravitetit tek i sëmuri me ostoartit të rëndë, mund të gjejnë mjedisin e duhur për të shtuar volumin e lëvizjes brenda në banjë me më pak dhimbje. Sidoqoftë, për të përmirësuar stabilitetin dhe kapacitetin absorbues të goditjeve përmes fuqisë së përmirësuar të muskujve duhet të rekomandohen ushtrime fizike në tokë pas proce-



durës së hydroterapisë.

## SËMUNDJE TË TJERA QË MJEKOHEN TE PUSI UJI FTOHTË

*Sëmundje të brendshme.* Adenoide, anemi, anoreksi, astma, bronshit, defekte të qarkullimit të gjakut, ftohje, dhimbje barku, ethe, fisura, edema, sëmundje biliare, gastrit, nauze, vjellje, dispepsi, kapsllëk, syndrome i zorrës së irrituar, hemorroide, hypertension i lehtë, faringit, obezitet, sinozit, teshtitje.

*Sëmundje uro–gjinekologjike.* Urinim i pavullnetshëm, cistit, infertilitet, menopauza, çrregullime menstruale, depresion post-partum, syndrom premenstrual, sëmundje të prostatës, infeksione seksuale, sëmundje të veshkave, mosmbajtje të urinës. Pusi Uji Ftohtë quhet edhe me emrin Pusi i Grave, ndoshta për problemet e infertilitetit (shtatëzanisë).

*Sëmundje nervore.* Sindromi i lodhjes kronike, klaustrofobi (frikë nga qëndrimi në vende të mbyllura), depresioni, dhimbje koke, pagjumësi, migrenë, neuralgi, luhatje humori, dobësi muskulore, panik, stres, hernie diskale, dhimbje nervit shiatik, çrregullim të gjumit, vertigo.

Sëmundje të lëkurës dhe mukozave. Konjuktivit, psoriasis, dekubitus.

Të tjera:

- lëndime sportive, përgatitje atletike,
- për të stimuluar sistemin imunitar,
- për përmirësimin e muskujve dhe kyçeve të lënduara, për të zbutur dhimbjet e kokës,
- për promovimin e relaksimit, për të lehtësuar dhimbjet e punës.

Terapia me ujë të ftohtë nuk është për të gjithë:

Sëmundjet e rënda të zemrës dhe mushkërive paraqesin rrezikshmëri. Presioni i mundshëm i gjakut që shkaktohet nga uji i ftohtë mund të jetë i rrezikshëm në persona me tension të pakontrolluar të gjakut. Megjithatë praktikuesit thonë se hydroterapia mund të jetë e sigurt në hipertensionin arterial të lehtë 150-160/100 mm Hg, sidoqoftë duhet të kryhet një studim nga mjeku para kurës me ujë të ftohtë. Terapia me ujë të ftohtë te njerëzit e dobët, të hollë duhet të bëhet gradualisht. Terapia me ujë të ftohtë duhet të shmanget te sëmundjet akute, në dhimbje prapa kokës, në arterioskleroz, në sëmundjen e Reynaud.

## SHKENCA MODERNE KONFIRMON PËRFITIMET NË MJEKIMIN ME UJË TË FTOHTË

Në ftohje të shpeshta, në pagjumësi dhe sëmundje si me sipër, rrit funksionin imunitar, ul inflamacionin, ul dhimbjen. Rrit rrjedhjen e gjakut, metabolizmin, përmirëson sindromën e lodhjes kronike, balancon ciklin e gjumit dhe zgjimin.

**Hydroterapia** – mjekimi me ujë është 3 lloje:

1. **Uji i ëmbël** (comun), përdoret me banjë (të ngrohtë, të ftohtë, të alternuar) dhe me pije. Këtu futet Pusi Uji Ftohtë. Ka afërsi në përbërje dhe për pije me ujin e Glinës (Gjirokastër) porsi stacion për banjë është unikal në vendin tonë me temperaturë shumë të ulët 3$^{O}$C, me efekte të jashtëzakonshme e të pakrahasueshme me asnjë burim tjetër në Shqipëri dhe më gjerë për shërimin e sëmundjeve.
2. **Ujërat termale** – termoterapi. Burime me temperaturë të lartë (të nxehta) që vijnë nga thellësia e tokës dhe marrin me vete kripëra minerale dhe gazra. Qendra baleare termale në Shqipëri ndodhen në llixhat e Elbasanit, llixhat e Peshkopisë, në Leskovik, Benjë Përmet.
3. **Ujëra minerarë**. Ky ujë vjen nga burime të tokës dhe ka sasi më të mëdha kripërash minerare se uji i zakonshëm. Më të rëndësishëm janë përmbajtja gaz sulfuroz, karbonate-sulfate dhe radon radioaktiv. Llixhat e Elbasanit, Peshkopisë, Leskovikut dhe Benjës janë ujëra termalë dhe minerarë. Ujërat minerale, oligominerale zakonisht përdoren nga goja, në mëngjes esëll një bardhak duke e shtuar në vazhdim. Përdoren për banjën në inflamacione të lëkurës. Të njohura janë burimet në ishullin Elba, Scarperia (Firence), Comano (Trento). Ujërat sulfurozë përmbajnë squfur. Më shumë përdoren për banjë, por edhe për pije me aerosol apo irrigacion. Të përmendur janë Albulae (Roma), Rapolano (Siena), Santa Cesarea (Leçe), Porretta (Bologna), Aachen (Gjermani), Aix-les Bains (Francë).

## MEKANIZMI I VEPRIMIT TË HYDROTERAPISË

Në të 3 llojet e banjave, në ujin e ëmbël (komun), me ujërat minerarë, me ujërat termalë veprojnë faktorët e mëposhtëm:

- **Faktori mekanik**: Luan rol ndryshimi i forcës së gravitetit të organizmit në banjë. Trupi i nënshtrohet humbjes së peshës e për pasojë, lëvizshmëri e madhe e kyçeve. Ky lirim i lëvizjeve ka rëndësi të madhe për ushtrimet nën ujë, sidomos pas paralizave. Presioni i ujit më shumë manifestohet në regjionet me inde të buta si: lëkura, indi konjuktival, vazot e gjakut, pareti i barkut, që transmetohet në organet e brendshme e në diafragme. Në mushkri rivendoset gjendja e ekuilibrit me eliminim të ashtuquajturit "ajri rezervë". Po jo në efizemën pulmonare, në isuficiencën kardiake dmth., në këta të sëmurë nuk tolerohet. Hedhja e gjakut në aortë shtohet 25%, por zemra duhet të jetë e shëndoshë, të disponoje rezerva energjetike.

-**Faktori termik:** Vepron mbi lëkurë në 2 mënyra: nëpërmjet një stimuli direkt mbi nervat dhe vazot e gjakut dhe nëpërmjet mbi terminacione nervore të termoreceptorëve. Kjo ndodh edhe për faktin se banja liron substancë aktive që gjenden në lëkurë dhe që prodhojnë një diladacion të vazave të lëkurës, një rritje të lëvizjes së gjakut dhe ndryshim të temperaturës së lëkurës, gjë që provokon një zbrazje të rezervës së gjakut të brendësirave. Me rrugë neurovegjetative ndodh stimulacion i proceseve të shkëmbimit, një ndryshim në reaksionet e gjakut dhe rritje eksitabilitetit neuromuskulor. Këto spostime të vogla të "ekuilibrit acidobazik" të organizmit janë të rëndësishme, sepse stimulojnë të tjera procese si glandulat me sekrecione të brendshme.

-**Faktori kimik:** Ky vepron nëpërmjet lëkurës në mekanizmin "perspiratio insensibilis" dhe pirjes së ujit nga një bardhak çdo mëngjes esëll. Këtë e vazhdon në shtëpi, pasi kthehesh nga banja për 10-15 ditë. Efekti ndodh nga veprimi i elementeve kimikë, por edhe radioaktiv në banjë, si psh. radiumi, i cili konsiderohet si më i përshtatshëm dhe



Çadrat e turistëve tek 'Uji i ftohtë



Liqeni i Zi

është në përdorim edhe në spitalin onkologjik, por sigurisht me një dozim ekzakt. Njihet efekti dhe i kobaltit - kobalto terapi, i jodit radioaktiv, apo i radio jodit në formën e pirjes. Ujërat që përmbajnë radium torium mund të përdoren nga goja. Kanë përdorim në artritizëm, reumatizëm, neurite, uricemi, sëmundje endokrine, insuficiencën e vezoreve, tiroides, gjëndrave surenaleve, sterilitet femëror, distoni nervore, sëmundje të lëkurës. Stacionet termale ndodhen në Laurisia, ishulli Ischia, Merano-Montecatini (Itali), Baden-Baden (Gjermani), Luchon (Francë).

*Veprimi kimik dhe radioaktiv nëpërmjet lëkurës.* Ndodh shkëmbimi i joneve (atomeve me ngarkesë elektrike) me ngarkesë të kundërt (jone pozitive ose katione, jone negative ose anione), ndërmjet organizmit dhe likuidit të banjës. Ky shkëmbim i joneve nëpërmjet lëkurës paraqitet si fenomeni i hydroterapisë, bën që të ndryshojë bilanci mineral i organizmit. Këmbimi i joneve "transmineralizimi" kryhet me anë të mineralizimit (asimilim i mineraleve) dhe demineralizimi (eliminim i mineraleve). Minerale gjinden në formën e particelave të vogla, gjurmëve e për këtë quhen "element oligodinamik". Ndër ta, kryesorët janë metalet e rënda (hekuri, bakri, etj). Ata kanë funksione të rëndësishme jetësore në organizëm, kanë një rol të rëndësishëm në mbajtjen e shëndetit e në shërimin e sëmundjeve, veçanërisht në afeksionet inflamatore dhe infektive. Shumë burime ujërash kurues përmbajnë të tilla substanca dhe veprimi i terapisë me ujë në balneoterapi i atribuohet pjesërisht edhe prezencës së tyre në ujë.

Por duhet ditur se një konsumim i tepërt i metaleve të rëndë mund të shkaktojë helmim, gjë që në trajtimin balnear ky rrezik nuk ekziston.

*Veprimi hormonal:* Uji i ftohtë liron në trup substancë endorfine dhe citokininë. Lirimi i endorfinës në organizëm gjatë banjës aktivizon nervat sensorë që shkojnë në tru, stimulon sistemin autonom nervor në mënyra të ndryshme, kontrollon funksionin e pavullnetshëm të zemrës dhe frymëmarrjes. Hormoni endorfinë ul dhimbjet. Veprim të ngjashëm kanë edhe citokininat.

## STUDIMET E KRYERA DHE REZULTATET E ANALIZAVE LABORATORIKE TE PUSI UJI FTOHTË

Inxhinier gjeolog Selim Marishta dhe analizat e ujit të kryera në ndërmarrjen hidro-gjeologjike Tiranë. Përfundimet e analizave përcaktojnë, në ujë predominojnë anionet hidrokarbonate, sulfateklorure dhe kationet magneziale–natriumore. Mineralizimi i përgjithshëm rezulton i ulët, uji klasifikohet në ujëra të ëmbla, të freskëta dhe të lehta. Sipas temperaturës, futet në ujin e temperaturë të ftohtë, ndërsa sipas pH klasifikohet në aciditet të dobët deri në neutral. Fortësia e përgjithshme në gradë gjermane ujë shumë i butë, më e madhe se fortësia karbonate, uji klasifikohet joalkalinë. Uji ka temperaturë më të ulët në rajon dhe në të gjithë vendin tonë. Nuk grupohet në ujërat minerarë, por në ujërat e ëmbla dhe ujë i pijshëm i lehtë. Uji përmban vlera të larta të sulfateve të natriumit me pH neutral deri në acid të dobët.

Mjeku Sokrat Ziu , Higjenist – Epidemiolog dhe rezultatet e analizave të kryera higjienë- epidemiologji, Tiranë. Fortësia e përgjithshme në gradë gjermane 2,8-3 gradë , pH 7,5-8,5, uji përcaktohet alkaline i dobët. Në ujë predominojnë anionet $HCO_3$ 85.4 mg/l , sulfate 2.5 mg/l , klorure 14 mg/l dhe kationet natrium 0.04mg/l, magnesium 19.6 mg/l.

Doktor i shkencave Mahmut Xhelili dhe inxhinier kimist Bardhyl Zaimi japin analizat e kryera në laboratorin e bujqësisë. Mbizotërojnë anionet sulfate karbonate përcaktojnë mineralizim të përgjithshëm të lartë. pH 7.5-8.39 dhe ujin e klasifikojnë ujë alkaline i dobët me predominim të anioneve kloride, sulfate, karbonate. Sipas Bardhyl Zaimit, me ujin e pusit janë bërë matje me aparatura përkatëse ku vërehen emetime në atmosferë të elementeve kimike të radiumit, ceziumit dhe stronciumit të cilat kanë edhe veti radioaktive. Ky autor ka provuar duke pirë për 15 dite ujë nga pusi i ftohtë dhe duke evituar pirje uji nga burim tjetër. Efekti ka qenë njëlloj si me procedurën e banjës. Uji i pusit ka temperaturë më të ulët se të gjitha burimet në Shqipëri. I matur në periudhën e banjës (Top-Channel Albania, gusht 28.2016 ) temperatura e ambientit ishte 14$^{o}$C, ndërsa e ujit të pusit 3$^{o}$C. Sipas "Nouveau Larousse medical illustre' fq.113. Sipas temperaturës, ujërat klasifikohen: 0-5$^{o}$C – banja e ngrirjes, 5-10$^{o}$C banja shumë e ftohtë 10-15$^{o}$C.

Ramazan Bici, specialist dhe drejtues i Agjencisë dhe grumbullimit të bimëve mjekësore në Lenie jep të dhëna për shpërndarjen, gjendjen e tyre në Liqenin e Zi dhe zonat rreth tij si: Zona Uji i Ftohtë, Aisht e Zezë, mali Lenies, Rrasybeg, Valamare, Gurrëz.

Bime medicinale. Lule flete murrizi, verbaskum, lule tërfili, lule njëmijë fletë, lule agulice, lule thundërmushke, fletë hithri, fletë ferre e butë, lule basami, herba zhumbric, rigon, herba majaselli, çaj mali, rrënjë sanzi, shpatore, rrënjë shtare, rrënjë belladoni, rrënjë shpendre, kokërr trëndafili të egër, murriz, mollë e egër, dëllinjë, salep, xhirrokull.

Mendoj se studimet e thelluara klinike dhe kërkimet laboratorike duhet të vazhdojnë për të zbuluar mrekullinë e këtij pusi natyral çudibërës për shërimin e shumë sëmundjeve dhe rekreacionin e të gjitha grupmoshave.

**Pusi Uji Ftohtë, Liqeni i Zi, Mali Valamare, Mali Lenie, monumente natyrale me vlera dhe bukuri të rrallë**.

Mali Valamare, Liqeni i Z, Moçale me vendim të KM nr.676, datë 20.12.2002 për nga vlerat dhe rëndësia janë shpallur "zona të mbrojtura të monumenteve natyrore".

Pusi Uji Fothtë ndodhet 4 km në vije ajrore në lindje të fshatit Shënepremte dhe 300 m nga Liqeni Zi, në lartësi 1740 m mbi nivelin e detit. Liqeni i Zi është i veçuar nga 14 liqene që kanë origjinë akullnajore, të cilat ndodhen në verilindje të tij në fushën e Valamares dhe pranë malit të Valamares me lartësi 2373.4 m mbi nivelin e detit, më i larti në qarkun e Elbasanit. Këto liqene pas shkrirjes së akullnajave u mbushën me ujë, të cilët me ngjyrën karakteristike blu janë njëri më i bukur se tjetri.

Liqeni i Zi është i vendosur midis fushës Ymer Beut në lindje dhe malit Lenie në jug. Sipërfaqja rezulton 1.968ha dhe lartësia 1684m mbi nivelin e detit, me vije bregliqenore rreth 550m. Përreth liqenit shtrihet fusha e liqenit të Zi, fushë livadhore malore. Aty kullosin tufat e deleve dhe kopetë e kuajve. Në këtë fushë, pranë kroit me ujë të ftohtë brisk të liqenit. Ne, djalëria e fshatit kalonim netët e stinës së verës, bënim gara me kuaj e me mushka, prisnim barinjtë të zbrisnin e t'i fusnin në vatha delet nga malet përreth. Në këtë fushë po ngrihen hotele, do bëhet shoqëri, shëtitje e të sëmurëve dhe punonjësve, pse jo dhe studime mjekësore për ndryshimin në ecje, në përmirësimin fizik e funksional nga efekti banjë uji i ftohtë. Rreth fushës së liqenit në formë gjysmë rrethore ndodhen pyjet e ahut në jugperëndim me një freski të papërsëritshme në brendësi të tyre, me monopate, me dy përrenj malor që sjellin ujin në drejtim të fshatit dhe me një burim ujë të bollshëm në Ujësiras. Ne VL fillon brezi i pishës në lartësinë 1700m mbi nivelin e detit dhe mbi këtë nivel fushat alpine dhe subalpine me liqenet që përmendëm më sipër.

Banjat në pusin e ftohtë janë një mrekulli, por në këtë ambient ajo plotësohet dhe nga faktorë të tjerë si klima, lartësia dhe të gjithë faktorët meteorologjikë që veprojnë mbi trupin e njeriut. Influencat fotokimike të prodhuara nga drita termike dhe aerokimike, nga përmbajtja e minerale, lagështia, oksigjeni, ozone. Gjithashtu influencojnë mbi organizmin, presioni atmosferik, korrentet e ajrit bile dhe radiacioni kozmik. Në këtë ambient shëtitje në malin e Rasybekut me ahe të larta, me ajër të lagët e të freskët, me shtroje gjethe shekullore, me një aromë që të hap mushkëritë, një shëtitje në pyllin me pisha që të mbush me oksigjen dhe ozon. Një shëtitje në liqenet mbresëlënëse, fushat dhe shpatet e maleve shoqërohet me një aksion të fortë mbi trupin dhe psikikën e njeriut. Një banjë ajri në shi është kënaqësi dhe ka një veprim tonifikues dhe rifreskues.

***Mjek kirurg***

Dosjet e viteve 1993-2008, formulari-tip për informim në lidhje me ecurinë vendimeve

# Pronarët në Shkodër, ATP merr në shqyrtim 4400 dosje

## *Problematikat, procedurat për t'u njohur me ecurinë e shqyrtimit*

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën me 4400 dosje ish-pronarësh, që janë në proces shqyrtimi nga kjo agjenci. Kërkuesit janë në qarkun e Shkodër. Në listën e përditësuar jepet numri i dosjes dhe data e aplikimit, gjeneralitet e kërkuesit, sipërfaqet e njohura për kompensim, dosjet për pronarët që kanë marrë vendim negativ dhe dosjet që duhet të plotësohen. Dosjet janë të viteve 1993 deri në vitin 2008. Agjencia e Trajtimit të Pronave ka vënë në dispozicionin të pronarëve formularin-tip, "Informacion në lidhje me ecurinë e dosjes", i cili duhet të plotësohet dhe të dorëzohet në 'Agjenci' për t'u njohur me fazën në të cilën ndodhet shqyrtimi i saj. Agjencia Trajtimit të Pronave është e detyruar që brenda 15 ditëve nga momenti i dorëzimit të kërkesës t'i kthejë përgjigje pronarit në lidhje me ecurinë e dosjes.

**FORMULARI**

Formulari i aplikimit për informacion në lidhje me ecurinë e dosjes është i ndarë në tri seksione. Aplikanti duhet të plotësojë gjeneralitet, adresën dhe të jetë i pajisur me mjet identifikimi në momentin e aplikimit. Në seksionin e dytë duhet të jetë përshkruar në mënyrë të saktë se në lidhje me çfarë kërkon informacion pala e interesuar, në këtë rast pronari që ka aplikuar për kthim e kompensim prone. Dhe në seksionin e fundit janë të specifikuara pesë dokumentet që duhet të disponojë pronari në momentin e aplikimit.

**APLIKIMI**

Për t'u njohur me ecurinë e dosjes, subjekti duhet të plotësojë dhe të paraqesë dorazi ose me postë pranë ATP-së kërkesën përkatëse me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes, fotokopje të kartës së identitetit, dëshmi trashëgimie dhe prokurë të posaçme. Në faqen zyrtare të ATP-së mësohet se subjekti plotëson kërkesën me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes pranë Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun, në 'Agjenci'. Më pas, kërkesa i kalon zyrës së protokollit, e cila pasi e protokollon, ia dërgon të gjitha kërkesat e ardhura drejtorit të përgjithshëm. Kreu i AKKP-ës ia delegon kërkesat sektorit përkatës për ndjekje dhe zbatim. Më pas, sektori përkatës përgatit informacionin e kërkuar dhe njofton subjektin. Në përfundim të shqyrtimit, subjekti paraqitet pranë zyrave të ATP-së për të tërhequr shkresën e kthimit të përgjigjes në lidhje me ecurinë e dosjes ose i dërgohet me postë, sipas kërkesës. Aplikimi për kërkesën për informim mbi dosjen nuk ka kosto.

**DOKUMENTACIONI QË DUHET TE PARAQISNI**

- Formulari-tip
- Fotokopje e kartës së identitetit
- Kopje vendimi nga ish-KKP/AKKP (nëse ka)
- Dokumente të tjera




**SHKODER**

| Nr./Dosjes | Data/ Dosjes | Rrethi | Emri (Subjekti Kërkues) | Mbiemri (Subjekti Kërkues) | Sip. E Njojhur/ Mosnjohje M2 | Sip. E Kompensuar M2 | Problematika |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 245 | 24.08.1994 | Shkoder | Rrok | Kota | Negativ, per mungese dokumentacioni | | |
| 384 | 31.08.1994 | Shkoder | Arben | Kopliku | Negativ, per mungese dokumentacioni | | |
| 597 | 16.03.2000 | Shkoder | Trashegimtaret | Hasanaj | 1720 | 1 720 | |
| 544 | 21.06.1996 | Shkoder | Trashegimtaret | Zeneli | 5500 | | |
| 321 | 30.08.1994 | Shkoder | Trashegimtaret | Dushi | 1 000 | 400 | |
| 320 | pa date | Shkoder | Trashegimtaret | Shestani | 950 | 450 | |
| 592 | 22.10.1998 | Shkoder | Trashegimtaret | Vasa | 1 500 | 300 | |
| 451 | 20.08.1994 | Shkoder | Prena | Simoni | 13050 | | |
| 115 | 01.08.1993 | Shkoder | Agetina | Suma (Pistulli) | Negativ, per mungese dokumentacioni | | |
| 485 | 17.08.1995 | Shkoder | Hamid | Gera | Negativ, per mungese dokumentacioni | | |
| 441 | 22.12.1994 | shkoder | Anton | Lami | Negativ, per mungese dokumentacioni | | |
| 362 | 29.08.1994 | Shkoder | Vat | Selmani | Negativ, per mungese dokumentacioni | | |
| 368 | 29.08.1994 | Shkoder | Muhamet | Shala | Negativ, per mungese dokumentacioni | | |
| 276 | 26.08.1994 | Shkoder | Aleksander | Raka | Negativ, per mungese dokumentacioni | | |
| 571 | 03.10.1996 | Shkoder | Ahmet | Rexhaj (Reshkovia) | 5000 | 5000 | |
| 132 | 23.03.1994 | Shkoder | Trashegimtaret | Ademi | | 12200 | |
| 383 | 31.08.1994 | Shkoder | Qemal | Vuci | Negativ, per mungese dokumentacioni | | |

| Nr./Dosjes | Data/ Dosjes | Rrethi | Emri (Subjekti Kërkues) | Mbiemri (Subjekti Kërkues) | Sip. E Njojhur/ Mosnjohje M2 | Sip. E Kompensuar M2 | Problematika |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 422 | 07.12.1994 | shkoder | Gjon | Saraci | Negativ, per mungese dokumentacioni | | |
| 16 | 25.10.1993 | Shkoder | Aldo | Zadrima | Negativ, per mungese dokumentacioni | | |
| 314 | 30.10.1994 | Shkoder | Gani | Villaj | Negativ, per mungese dokumentacioni | | |
| 403 | 31.08.1994 | Shkoder | Skender | Quku | Negativ, per mungese dokumentacioni | | |
| 538 | 13.06.1996 | shkoder | Trash. | Hasa | 700 | 400 | |
| 272 | 25.08.1994 | Shkoder | Namik | Bushati | Negativ, per mungese dokumentacioni | | |
| 191 | 01.06.1994 | Shkoder | Agim | Neziri | Negativ, per mungese dokumentacioni | | |
| 387 | 31.08.1994 | Shkoder | Trash.Plepi | | 3000 | 3000 | |
| 157 | 28.03.1994 | Shkoder | Myzafer | Garuci | Negativ, per mungese dokumentacioni | | |
| 74 | 26.02.1994 | shkoder | Trash.Hurdha | | 100 | 100 | |
| 447 | 25.01.1995 | shkoder | Muhamet | Qerkapia (Rexha) | Negativ, pasi eshte trajtuar me v. 91, dt.04.09.1994 | | |
| 459 | 22.08.1996 | Shkoder | Musa | Heta | Negativ per mungese dokumentacioni | | |
| 116 | 22.03.1994 | shkoder | Adem | Gemi | Negativ per mungese dokumentacioni | | |
| 608 | 18.11.2002 | Shkoder | Trasheg. | Gjoni(Toma) | 81500 | | |
| 607 | 11.11.2002 | shkoder | Trash.Lluka | | 10000 | 10000 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 205 | 11.07.1994 | Shkoder | Trash.Tanushi | | 37138 | 6208 | |
| 609 | 18.11.2002 | Shkoder | Bashkia Islamike Xhamija Mes | | 17500 | 6150 | |
| 610 | 17.04.2003 | Shkoder | Trash.Fusha | | 3500 | 1300 | |
| 613 | 11.06.2004 | Shkoder | Trash.Palaj | | 300 | | |
| 611 | 19.05.2004 | Shkoder | Trash.Haxhi | | 10010 | 10010 | |
| 612 | 25.05.2004 | Shkoder | Trash.Halluni | | 20000 | 11000 | |
| 599 | 03.07.2000 | Shkoder | Mark | Kamberi | 10000 | | |
| 601 | 28.09.2000 | Shkoder | Hil ; Ndoc | Babani | 10000 | | |
| 603 | 01.06.2001 | shkoder | Osman | Vataksi | 8360 | 450 | |
| 602 | 25.04.2001 | Shkoder | Trash. | Masmalaj | 28000 | | |
| 604 | 0.07.2001 | Shkoder | Trash. | Boshi | 2500 | | |
| 589 | 13.01.1998 | Shkoder | Trash. | Deja | 6000 | | per sip. 1 700 m² dhe sip. 1 000 m² komisioni citon se jane te zena, por pa shprehur formen e njohjes. |
| 17 | 03.04.1998 | Shkoder | Trash.Rroku | | 70000 | | |
| 433 | 20.02.1996 | Shkoder | Bashkesia Islamike (Xhamija Shiroke) | | 2634 | 60 | Ne dosje eshte I depozituar edhe vendimi nr. 371, dt. 05.02.1993 I KKKP Rrethit Shkoder, I cili I njeh dhe kthen Bashkesise Islamike godinen e Xhamise Shiroke. |
| 44 | 16.02.2002 | Shkoder | Trash.Stani | | 9400 | | |
| 600 | 03.07.2000 | Shkoder | Trash.Livadhi | | 9400 | | ka lidhje me dosjen 599, dt. 03.07.2000 ne emer te Mark Kamer |
| 432 | | Shkoder | Keshilli Xhamise Barbullush | | 12775 | 5275 | |
| 370 | 31.08.1994 | Shkoder | Trash.Kavaja | | 8000 | 8000 | |
| 282 | 29.08.1994 | shkoder | Trashegimtaret Jubani | | 93500 | 93500 | |
| 598 | 05.04.2000 | Shkoder | Shuke ; File ; Mark | Ndoca | 1000 | | |
| 541 | 19.06.1996 | Shkoder | Gjon | Gjoni | Negativ per mungese dokumentacioni | | |
| 21 | 04.06.1996 | Puke | Zef | Manushi | 11400 | 11400 | |
| 16 | 25.03.1996 | Puke | Zeqir | Kasemi | 19025 | 19025 | |
| 19 | 28.03.1996 | Puke | Muhamet | Cenaj | 18810 | 18810 | |
| 7 | 27.12.1996 | Puke | Marije | Koleci | 5122 | 5122 | |
| 11 | 08.08.1995 | Puke | Nikolle | Gjini | 8500 | 8500 | |
| 12 | 08.03.1996 | Puke | Nike | Zefi | 45498 | 35428 | |
| 22 | 28.06.1993 | Puke | Mynever | Kasemi | 7760 | 7760 | |
| 14 | 19.07.1996 | Puke | Xhemile | Kasemi | 16900 | 16900 | |
| 23 | | Puke | Sulejman | Gania | 31000 | 31000 | |
| 10 | 08.02.1995 | Puke | Raze | Hyseni | 4267 | 4267 | |
| 13 | | Puke | Lule | Marku | 23500 | 5900 | |
| 18 | | Puke | Halit | Dini | 11250 | 11250 | |
| 17 | 19.06.1996 | Puke | Zarie | Pema | 4766 | 4766 | |
| 1 | 16.11.1994 | Puke | Ded | Shpendi | 19250 | 18410 | |
| 3 | | Shkoder | Shtjefen | Nika | 4000 | 3410 | sip 590 eshte perfituar me l. 7501 |
| 25 | pa date | Shkoder | Xhane | Guri | Negativ, per mungese dokumentacioni | | |
| 5 | pa date | Puke | Trash. | Pjetri | 10000 | 10000 | |
| 24 | | Puke | Selim | Prishtina | Negativ per mungese dokumentacioni | | |
| 4 | pa date | Puke | Lule | (Alija) | 5250 | 5250 | |
| 4 | 0.02.2003 | Puke | Shpend | Ahmetaj | 30175 | | |
| 8 | | Puke | Jak | Lleshi | 7400 | 7400 | |
| 6 | | Puke | Ndue | Kola | Negativ per mungese dokumentacioni | | |
| 9 | | Puke | Trash. | Leka | 11410 | 11410 | |
| 15 | 28.05.1996 | Puke | Abedin | Lluka | Negativ per mungese dokumentacioni | | |
| 37 | V. 1994 | Shkoder | Trash. | Shkreli | 4100 | | |
| 81 | V. 1994 | Shkoder | Trash. | Gjoka | 8500 | | |
| 80 | V. 1994 | Shkoder | Trash. | Matusha | 5600 | | |
| 79 | V. 1994 | Shkoder | Trash. | Matusha | 8700 | | |
| 54 | V. 1994 | Shkoder | Trash. | Ndokaj | 3000 | | |
| 69 | V. 1994 | Shkoder | Lazer | Radovani | 100 | 100 | |
| 60 | V. 1994 | Shkoder | Trash. | Bardhi | 8000 | | |
| 47 | 15.12.1993 | shkoder | Trash. | Shmarqi | 5300 | | |
| 95 | V. 1994 | Shkoder | Keshilli Kishes Katolike | | 2552 | | Ne dosje ndodhet edhe v. nr. 41/1, dt. 28.09.95, me te cilin Kishes I eshte njohur sip. 3080 m² truall ne Shiroke nga e cila s1=320 me parablerje,S2= 1900 me kthim, S3= 860 me kompensim. |
| 44 | 28.12.1993 | Shkoder | Trash. | Kraja | 4000 | | |
| 70 | V. 1994 | Shkoder | trash. | Canja | 530 | | |
| 84 | V. 1994 | Shkoder | Llesh | Vuksani | 1 000 | | |
| 64 | 08.02.1994 | Shkoder | Abdyl | Sokoli | 2621 | 600 | |
| 38 | V. 1994 | Shkoder | Dode | Grimaj | 5000 | | |
| 57 | 09.01.1994 | Shkoder | Trash. | Marku | 10000 | | |
| 346 | 30.08.1994 | Shkoder | Feride | Ujka (Bala) | 7700 | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 345 | 30.08.1994 | shkoder | Trash. | Rama | 1 000 | 1 000 | |
| 338 | 30.08.1994 | Shkoder | Sadnder | Lufi | 10 850 | | |
| 317 | 30.08.1994 | Shkoder | Isa | Vlashi | 5700 | 5700 | |
| 318 | 30.08.1994 | Shkoder | Elez | Tahiri | 1000 | 1000 | |
| 300 | 29.08.1994 | Shkoder | trash. | Bacani | 3850 | 3850 | |
| 329 | 30.08.1994 | Shkoder | Trash. | Muja | 2300 | 2300 | |
| 97 | 17.03.1994 | Shkoder | trash. | Plangaj | 72 | | |
| 342 | 30.08.1994 | Shkoder | trash. | Mirush | 2300 | 2300 | |
| 280 | 29.08.1994 | Shkoder | Trash. | Kali | 3000 | 2000 | |
| 235 | 22.08.1994 | Shkoder | Hava ;Fetije | Cafi | 2000 | 1500 | |
| 266 | 25.08.1994 | Shkoder | Trash.Zeneli | | 4250 | 4250 | |
| 263 | viti 1995 | Shkoder | Ndreke | Ndoci | 2000 | 2000 | |
| 409 | 31.08.1994 | Shkoder | Trash.Zejnuni | | 4000 | | |
| 452 | 20.03.1995 | Shkoder | Trash.Lujkaj | | 7000 | 1200 | |
| 406 | Viti 1995 | Shkoder | Qazim | Kastrati | 7500 | | |
| 217 | 27.07.1994 | Shkoder | Trash.Celepija | | 12100 | | |
| 310 | viti 1995 | Shkoder | Trash.Lutfija | | 7000 | 4900 | |
| 230 | 16.04.1994 | Shkoder | Arqipeshkvia Shkoder | | | | Ka vertetim kadastre si vertetim pronesie |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |
| 285 | 30.08.1994 | Shkoder | Asim | Zambaku | 4000 | | |
| 160 | viti 1995 | shkoder | Musa | Ymeri | 10000 | 10000 | |
| 194 | 18.03.1995 | Shkoder | Eljaz | Duli | 9000 | 9000 | |
| 106 | 18.03.1994 | Shkoder | Ramiz | Sylja | 2000 | 2000 | |
| 161 | 28.03.1994 | Shkoder | Isidor | Banushi | 1000 | 500 | |
| 214 | 25.07.1994 | Shkoder | trash. Curani | | 6150 | | |
| 17 | 25.10.2013 | Shkoder | Trash. Marubi | | 1850 | 250 | |
| 96 | viti 1995 | shkoder | Trash. Gjinaj | | 2000 | | |
| 180 | viti 1995 | Shkoder | Trash. Jusi | | 2008 | | |
| 94 | 16.03.1994 | Shkoder | Trash. Tahiri | | 6300 | 6300 | |
| 443 | 09.01.1995 | Shkoder | Trash. Ejlli | | 800 | 300 | |
| 336 | 30.08.1994 | shkoder | Halil | Zeneli | 2750 | | |
| 298 | 29.08.1994 | Shkoder | Trash. Sokoli | | 500 | | |
| 457 | 26.04.1995 | Shkoder | Trash. Velija | | 2400 | | |
| 354 | 31.08.1994 | Shkoder | Qazim | Haruolli | 4300 | 900 | |
| 414 | 21.10.1994 | Shkoder | Trash. Brahimi | | 8000 | 8000 | |
| 238 | 22.08.1994 | shkoder | Trash. Pergjini | | 500 | 500 | |
| 169 | 28.03.1994 | shkoder | Trash Gjylbegu | | 10000 | 9000 | |
| 331 | 30.08.1994 | Shkoder | Tom | Rriana | 5300 | | |
| 241 | 23.08.1994 | shkoder | Fahri | Osja | 8500 | 6900 | |
| 281 | 29.08.1994 | Shkoder | Trash.Kroj | | 3800 | 3500 | |
| 363 | 31.08.1994 | shkoder | Trash.Neziri | | 8000 | 8000 | |
| 421 | 31.08.1994 | Shkoder | Hamza | Mema | 10000 | 10000 | |
| 396 | 31.08.1994 | Shkoder | Trash.Enjlli | | 500 | 500 | |
| 450 | 09.03.1995 | Shkoder | Liljana ; Marije | Çefa | 5000 | | |
| 412 | 31.08.1996 | shkoder | Muhamet | Haxhaj | 10500 | 10500 | |
| 455 | 07.04.1995 | Shkoder | Ramadan | Gjoka | 11500 | 11500 | |
| 454 | 23.03.1995 | Shkoder | Trash. Lahi | | 7500 | 6500 | |
| 415 | 31.08.1994 | Shkoder | Trash. Hasmegaj | | 6200 | 4300 | |
| 381 | 31.08.1994 | Shkoder | Trash. Behari | | 1 000 | | Me vendimin nr. 332, dt. 27.03.2001, te gjykates se rrethit Shkoder eshte ndryshuar vendimi 229, dt. 14.04.1995, duke vendosur kthim te sip. 200 m² dhe njohjen e pronesise sipas nenit 21. |
| 456 | 25.04.1995 | shkoder | Fadil | Hasani | 2000 | 2000 | |
| 424 | 01.02.1995 | shkoder | Ali | Brahimi | 10000 | 10000 | |
| | | | | | 174 | | |
| | | | | | 1152 | 55 | |
| 388 | 31.08.1994 | Shkoder | Trash. | Gjoka | 500 | 500 | |
| 248 | 24.03.1994 | Shkoder | Trash. | Pavaci | 3850 | 2580 | |
| 171 | 29.03.1994 | Shkoder | Skender | Taipi | 9000 | | |
| 444 | 13.01.1995 | Shkoder | Trash. Kola | | 8300 | | |
| 413 | 31.08.1994 | Shkoder | Trash. Hasaj | | 750 | | |
| 361 | 31.08.1994 | shkoder | Trash. Cafi | | 5400 | 5400 | |
| 357 | 31.08.1994 | Shkoder | Trash. Çoba | | 5000 | 5000 | |
| 23 | 02.02.1994 | Malesi e Madhe | Fran | Lumaj | 3000 | | |
| 22 | 07.02.1994 | Malesi e Madhe | Pjeter ; Leze | Aliaj | 4000 | | |
| 41 | 24.03.1994 | Malesi e Madhe | Trash.Lunaj | | 3200 | | Ne dosje ekziston dhe v. nr. 16/1 dt. 26.12.1995 I cili njeh dhe kompenson sip 2400 m² truall te ndodhur ne Ivanaj Kastrat |
| 44 | 28.03.1994 | Malesi e Madhe | Trash. Ashta | | 375 | | Ne dosje eshte i depozituar edhe vendimi nr. 19/2 dt. 21.05.2002 i ish KKKP Rrethit M. e Madhe, i cili i kthen ne natyre subjektit te shpronesuar Nik Gjergj Purashi siperfaqen prej 35 006 m². Ky vendim nuk ka lidhje me vendimin nr. 17,dt. 29.07.1994, ne emer te subjektit te shpronesuar Cin e Lule Ashta |

*(vijon)*

38-vjeçari kishte arritur që t'i shmangej arrestimit disa herë duke plagosur pjesëtarët e policisë

# Maqedoni, ekzekutohet shqiptari i dënuar me 25 vjet për vrasje

## *Jeton Rexhepi u arratis 4 herë nga burgu*


Jeton Rexhepi

Një shqiptar i dënuar me 25 vjet burg, ka mbetur i vrarë ditën e djeshme në Tetovë në përpjekje për t'iu shmangur policisë. Jeton Rexhepi, 38 vjeç, ishte arratisur shumë vite më parë nga burgu dhe kjo ishte tentativa e katërt e policisë për ndalimin e tij. Burimet bëjnë me dije se Rexhepi ishte i armatosur dhe është kundërpërgjigjur drejt Forcave Speciale që kishin shkuar për ta arrestuar në orët e para të mëngjesit. Policia kishte tentuar ta ndalonte edhe në vitin 2012, në 2014 si dhe në 2016, por i dënuari i arratisur nga burgu i Shtipit ia kishte dalë t'i arratisej policisë.

Të dhëna jozyrtare flasin se Rexhepi akuzohej gjithashtu edhe për një rrëmbim, gjatë viteve të tij të arratisë.

**NGJARJA**

Gjatë ditës së djeshme banorët e fshatit Llërcë të Komunës së Zhelinës janë zgjuar nën zhurmën e plumbave dhe bombave. Fshati ishte rrethuar nga forca të mëdha policore, të cilët kërkonin të arrestonin 38-vjeçarin, Jeton Rexhepi, i cili është i njohur për policinë dhe opinionin për kryerjen e shumë veprave penale. 38-vjecari ishte kthyer në një njeri të pakapshëm për autoritetet policore vendore, të cilët kishin lëshuar edhe urdhërarrest vendor dhe ndërkombëtar pasi kishte arritur që t'i shmangej arrestimit disa herë madje edhe duke plagosur pjesëtarët e policisë. Sakaq, duke pasur parasysh që policia disa herë kishte dështuar gjatë arrestimit, është përgatitur një plan më i gjerë për arrestimin e tij. "Duke marrë parasysh njohuritë dhe vlerësimet e sigurisë, se Jeton Rexhepi paraqiste kërcënim serioz të sigurisë për jetën e qytetarëve dhe të pjesëtarëve të policisë, është përgatitur plan i posaçëm, që të arrestohet. Në orët e hershme të mëngjesit, në shtëpinë e tij në fshatin Llërcë, gjatë marrjes së masave dhe aktiviteteve për ta privuar nga liria, ai ka hedhur një bombë dore ndaj pjesëtarëve të policisë dhe më pas ka ikur. Ka qenë i veshur me xhaketë antiplumb, i armatosur me pushkë automatike, me tre karikator të mbushur, me municion për pushkë automatike, me karabinë, armë zjarri e tipit TT 7.62, me karikator të mbushur me municion dhe katër bomba dore. Pas tentimit të dytë për ta arrestuar, në një distancë prej rreth 200 metra në afërsi të shtëpisë së tij, përsëri ka hapur zjarr ndaj pjesëtarëve të policisë, prapë është kapur për bombën e dorës dhe ka tentuar që ta përdor të njëjtën ndaj tyre, kështu që policia është përgjigjur sulmit duke e vrarë",-thuhet në njoftimin e policisë. Që në orët e para të mëngjesit të së hënës, forca të mëdha policore kanë qenë të pranishme në fshatin Llërcë ku banoret janë shprehur të shqetësuar për praninë e madhe të policisë. Në mesditë, trupi i pajetë i Jeton Rexhepit është marrë për verifikim, ndërsa ekipet e gazetarëve deri vonë nuk janë lejuar të hyjnë në fshat. Po ashtu, në vendngjarje kanë qenë edhe ekipet e Mjekësisë Ligjore dhe të Prokurorisë Themelore të Tetovës

**AKUZA**

"Kemi të bëjmë me një person, i cili në periudhë prej vitit 2000 deri në vitin 2016, janë shqiptuar gjashtë akuza penale, për 16 forma të rënda të veprave penale edhe atë, për 'vrasje', 'tentim vrasje', 'grabitje', 'armëmbajtje pa leje', 'rrëmbim' e kështu me radhë.

Partia e tij u mbështet nga nacionalisti hungarez Orban

## Zgjedhjet parlamentare në Slloveni, fiton ish-kryeministri Janez Jansha



Pas numërimit të shumicës së votave rezulton se ish-kryeministri Janez Jansha është fitues i zgjedhjeve parlamentare të Sllovenisë.

Sipas zyrtarëve, "SDS"-ja ka fituar 25% të mbështetjes, ndërsa si parti e dytë me 12.7% të votave ka rezultuar "Lista e Marjan Sareçit", një parti politike e themeluar nga Marjan Sareç, një ishgazetar, aktor dhe komedian. Sllovenia u detyrua të shkonte në zgjedhje që prej muajit mars, pasi kryeministri i qendrës së majtë, Miro Cerar dha dorëheqjen pas mosmarrëveshjeve brenda koalicionit. Përmes një fjalimi televiziv, 59-vjeçari Jansha ka thënë se partia e tij i ka dyert e hapura dhe është e gatshme për koalicion me të gjitha partitë. "Partia jonë vendos Slloveninë, sllovenët të parët. Ne jemi të hapur për bashkëpunim",- deklaroi ai. Jansha ka qenë kryeministër në periudhat 2004-2008 dhe 2012-2013. Ai ka kaluar gjashtë muaj në burg më 2014, pas dënimit të bazuar në akuza për ryshfet, të lidhura me një marrëveshje për armët më 2006, mirëpo është liruar pasi Gjykata Kushtetuese ka urdhëruar një rigjykim, i cili nuk u zhvillua për shkak të skadimit të afatit kohor dhjetëvjeçar. Ai njihet si aleat i kryeministrit hungarez me qasje kundër migrantëve, Viktor Orban. "Për shkak të politikës së tij për migrimin, Hungaria tani është shtet i sigurt, derisa Belgjika nuk është", pati thënë Jansha përmes një postimi në Tëitter. Votuesit në disa shtete anëtare të Bashkimit Europian, duke përfshirë Hungarinë dhe Poloninë, kanë përkrahur partitë që kundërshtojnë planet e bllokut, sipas të cilit shtetet duhet të pranojnë azilkërkues sipas kuotave. Partia e Janshas, e mbështetur nga nacionalisti hungarez, Viktor Orban, kundërshton ashpër këto kuota, duke thënë se shumica e të hollave që përdoren për të mbështetur azilkërkuesit duhet të ndahen për forcat e sigurisë, tha ai. "SDS"-ja do të ketë 25 vende në Asamblenë Kombëtare 90-vendëshe. "SDS"-ja është shprehur se paratë e shpenzuara ndaj emigrantëve do të mund të përdoreshin më mirë për forcat e sigurisë së vendit.

"Joserioz dhe antikushtetues"

## LDK vendim kundër Thaçit për platformën e dialogut



Grupi Parlamentar i LDK-së ka marrë gjatë ditës së djeshme vendim që të mos e votojë platformën për dialog, e prezantuar në Kuvendin e Kosovës nga ana e qeverisë së Kosovës. Sipas LDK-së, platforma për dialog është dokument i përgatitur dobët, joserioz dhe me pretendime jokushtetuese. "LDK-ja mbetet e përkushtuar për një proces dialogues serioz, konsensual dhe brenda kornizave kushtetuese të Republikës së Kosovës. LDK-ja beson në vlerat e pazëvendësueshme të dialogut politik, jo vetëm si një mjet për marrëveshje, por edhe si një qenësi e jetës politike",-thuhet në komunikatën e LDK-së. Platforma e ekzekutivit, që pret miratimin e Kuvendit, ia beson kreut të shtetit rolin drejtues në këtë proces. Ky i fundit gjendet i detyruar ta informojë rregullisht parlamentin për bisedimet e zhvilluara në Bruksel. Dokumenti synon që Kosova dhe Serbia, me ndërmjetësimin e Bashkimit Europian, të arrijnë një marrëveshje ndërkombëtare, ligjërisht të detyrueshme për të dyja palët, e cila për Kosovën do të ratifikohej nga Kuvendi si organi më i lartë. Nëpërmjet këtij pakti, Prishtina shpreson të sigurojë heqjen e barrierave të krijuara për anëtarësimin e saj në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, në Bashkimin Europian dhe strukturat e organizata të tjera ndërkombëtare. Por, partitë opozitare në Kosovë këmbëngulin që të mos jetë Hashim Thaçi në krye të procesit të dialogut me Serbinë, i cili tani po i afrohet fazës finale. Një muaj më parë, Komisioni parlamentar për Politikën e Jashtme votoi me shumicë të qartë kundër përmbajtjes së platformës së qeverisë, nën argumentin se ajo nuk është e plotë dhe ka shumë paqartësi për mënyrën sesi të përmbyllen bisedimet me Beogradin. Deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Drita Millaku, ka folur në lidhje me vendimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), që të mos e përkrahë platformën e qeverisë, rrjedhimisht rolin që kjo platformë i jep Presidentit, Hashim Thaçi. Millaku thotë se edhe LDK-ja e ka pjesën e fajit të vet në dialogun e deritashëm me Serbinë. "Së pari dua të them se edhe LDK-ja e ka pjesën e fajit të vet në dialogun e deritashëm me Serbinë. Faktikisht, deri sa ka qenë në qeverisje PDK dhe LDK asnjëherë nuk është raportuar për ecurinë e atyre bisedimeve. Duhet të bëhet një analizë e dialogut të deritanishëm se çka ka humbur Kosova në këtë dialog. E dimë shumë mirë se janë nënshkruar 33 marrëveshje ose më mirë me thënë mosmarrëveshje. Është edhe më e dhimbshme se si akoma diskutohet në LDK mundësia e udhëheqjes se Thaçit këtë dialog. Gjërat duhet të jenë të prera, Thaçi është e keqja Kosovës dhe duhet të bindet njëra e mirë LDK për këtë gjë",-është shprehur Millaku

## SOROS KUNDËR QEVERISË ITALIANE:



FOTOLAJM

**Financier nga më të njohurit, por edhe mbështetës i iniciativave politike liberale në Europën Lindore, George Soros është shfaqur "shumë i shqetësuar për influencën e Rusisë në Europë në përgjithësi dhe në qeverinë e re italiane'. Biznesmeni me origjinë hungareze ka sulmuar liderin e Lega-s. "Nuk e di nëse Salvini është financuar nga Moska, por opinioni publik ka të drejtë ta dijë. Putin, kërkon të dominojë Europën, ta shfrytëzojë, sepse ka kapacitet prodhues", është shprehur Soros.**

TRASHEGIMIA

Fatmira Nikolli

# SAIMIR SHPUZA:
## Mbretëria Ardiane, zbulohet qyteti ilir i para 2300 vjetëve në Bushat

*Siti i panjohur që shtrihet në 20 ha, të dhënat nga gërmimi për Ilirinë në shekujt 4-2 p.e.s.*





Në pamje të parë, i ngjante vetëm një toke bujqësore. Deri në vitet 1990, aty qe vendosur edhe një repart tanskesh. Në vitet 1980 u gjetën krejt rastësisht varre antike, mandej një fontanë e prapë, ajo dukej si një fushë krejt e zakonshme, derisa një grup arkeologësh duke përdorur metoda invasive, hasi në anomali që çuan më pas në një zbulim.

Një qytet ilir rreth 2300-2400 vjeçar ka dalë në dritë në zonën e Bushatit në Shkodër, gjatë gërmimeve arkeologjike të ekspeditës shqiptaro-polake. Saimir Shpuza në një intervistë për "Gazeta Shqiptare" thotë se lulëzimi i tij u shënua në shekujt 4-2 para erës sonë dhe se me rënien e mbretërisë ilire të Ardianëve, qyteti pësoi rënie graduale deri sa u braktis totalisht. I shtrirë në rreth 20 ha, sipërfaqja e tij është e përafërt me qytetet e tjera të mëdha të zonës si Shkodra dhe Lezha. Shpuza thotë se ende nuk është mësuar se cili ka qenë emri antik të këtij qyteti. Por pikërisht ky eksplorim drejt së panjohurës e bën punën e arkeologut ende më të bukur. Gjatë intervistës së mëposhtme ai shuan kuriozitetin për zbulimin më të fundit.

**- Një zbulim arkeologjik është bërë nga ekspedita që ju drejtoni në Bushat. Për çfarë siti bëhet fjalë? I cilës periudhë?**

Siti ku ne jemi duke përfunduar gërmimet arkeologjike gjendet në Bushat (Bashkia e Vaut të Dejës) 10 km në jug të qytetit të Shkodrës. Bëhet fjalë për një qytet ilir, pothuajse i panjohur deri më sot. Gërmimet nxorën në dritë një pjesë të fortifikimit antik të qytetit dhe njërën prej portave hyrëse të tij. Kjo portë ishte e mbrojtur edhe me një kullë me një sipërfaqe rreth 50 m2. Ky mur rrethues i qytetit datohet nga materiali arkeologjik i gjetur në fund të shekullit të 4 p.e.s., ose maksimumi në fillim të shekullit të 3-të p.e.s. Megjithatë, gjetjet më të hershme i takojnë periudhës së Hekurit të Hershëm, një periudhe historike kjo, që është shumë mirë e dokumentuar në të gjithë arealin e territorit të Shkodrës. Gjithashtu, me interes janë edhe gjetja e disa fragmenteve qeramike të periudhës arkaike dhe klasike, që mund t'u takojnë importeve nga Apolonia dhe Durrësi apo qyteteve të tjera të botës greke. Sidoqoftë, zbulimi kryesor mbetet fortifikimi i një qyteti ilir në Bushat.

**- Çfarë shtrirjeje ka? Është sit i madh?**

Një nga synimet e ekspeditës sonë ka qenë edhe përcaktimi i shtrirjes së këtij siti. Për këtë arsye jemi përpjekur të rilevojmë çdo strukturë të dukshme në sipërfaqe, sidomos ato struktura që mund t'i përkasin murit fortifikues të qytetit. Ky lloj dokumentimi na lejoi që të krijonim një kuadër të qartë për shtrirjen e sitit. Në fakt, bëhet fjalë për një sipërfaqe shumë të madhe, që arrin deri në 20 ha. Kjo sipërfaqe është shumë e përafërt me qytetet e tjera të mëdha të zonës si Shkodra dhe Lezha. Gjithashtu, edhe shtrirja topografike e qytetit, të organizuar në dy pjesë, qytet i sipërm dhe qytet i poshtëm, është shumë e ngjashme me qytetet e tjera të këtij pellgu si Shkodra, Lezha, Ulqini dhe Zgërdheshi.



**- Si qëndron ky qytet i ri i zbuluar në krahasim me site të tjera shqiptare për nga rëndësia dhe hapësira që zë?**

Identifikimi i një qyteti të ri ilir në këtë areal, i cili korrespondon me zemrën e Mbretërisë ilire të Ardianëve, hedh një dritë të re për dendësinë e jetës qytetare në Iliri në shekujt 4-2 p.e.s. Brenda një territori shumë të kufizuar, siç është hapësira mes Shkodrës dhe Lezhës, arrijmë të identifikojmë një qytet të ri në Bushat, çka flet në favor të një jete qytetare të lulëzuar. Po të shikosh hartën e qyteteve në Iliri, arrin të dallosh se sa më larg në drejtim të veriut të shkojmë, aq më e rrallë bëhet prania e qyteteve tek ilirët. Ndërkohë që gërmimet që po kryejmë po tregojnë të kundërtën dhe me shumë mundësi ky perceptim i gabuar për jetën qytetare tek ilirët e veriut është krijuar si rrjedhojë dhe e gërmimeve të pakta që janë realizuar në këto rajone deri më sot. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për territorin përreth Shkodrës dhe Bushatit, ku ekspedita jonë e përbashkët shqiptaro-polake (Instituti i Arkeologjisë Tiranë dhe Universiteti i Varshavës) ka identifikuar një numër të madh kullash vrojtimi dhe fortifikimesh rurale të po kësaj periudhe, që kanë luajtur rolin e mbrojtjes territoriale të këtyre qyteteve.

**- A keni gjetur edhe artefakte?**



Artefaktet e gjetura janë kryesisht fragmente qeramike. Më të pakta në numër janë objektet metalike. Gjetjet e periudhës romake janë shumë të pakta, ndërkohë që qeramikat më të vona që kemi gjetur i takojnë shekullit të VI të e.s. Për momentin të dhënat që na vijnë nga këto gjetje janë të kufizuara dhe nuk mund të shprehemi në mënyrë kategorike, por ideja e përgjithshme që kemi krijuar është se lulëzimi i këtij qyteti ka qenë në shekujt 4-2 p.e.s., ndërkohë që pas rënies së mbretërisë ilire qyteti ka pësuar një rënie graduale deri sa është braktisur totalisht. Sidoqoftë, gjetjet sporadike që na vijnë nga fushat përreth sugjerojnë se mund të ketë pasur një zhvendosje të jetës nga kodrat e fortifikuara drejt fushave dhe pranë akseve kryesore të komunikimit gjatë periudhës romake. Kjo braktisje e qytetit gjatë periudhës romake ka sjellë që qyteti ilir që ne shpresojmë të zbulojmë të jetë i ruajtur në gjendje shumë të mirë, pasi pas braktisjes, qyteti nuk është banuar më në mënyrë të dendur. E kundërt ishte situata në Shkodër, qytet i cili ka pasur rëndësi të dorës së parë gjatë gjithë historisë dhe ku kemi gërmuar prej 7 vjetësh, ku strukturat më të hershme të qytetit ilir janë krejtësisht të shkatërruara, ose të ripërdorura nga ndërtimet e periudhës veneciane dhe osmane. Si rrjedhojë, ato janë të papërceptueshme sot nga ana arkeologjike.

**- Çfarë vlere i shton zonës përreth?**

Për nga vetë pozicioni gjeografik ku gjendet siti arkeologjik i Bushatit, premton se në një të ardhme shumë të afërt mund të kthehet i vizitueshëm. Siti gjendet buzë rrugës kombëtare Shkodër-Lezhë dhe në pjesën më të madhe nuk ka asnjë vështirësi fizike për t'u vizituar. Plus kësaj, siç e thashë edhe më sipër gjendja e ruajtjes së strukturave është e mirë, çka e bën sitin shumë të lexueshëm nga vizitorët. Për më tepër, në këtë gërmim kemi pasur një mbështetje shumë të madhe si nga institucionale rajonale të trashëgimisë, ashtu edhe nga pushteti lokal në Bashkinë e Vaut të Dejës, çka flet për një interes të madh nga të gjithë aktorët që Bushati të bëhet shpejt një ndalesë për turistët.

**- Si nisi gërmimi?** Kishte të dhëna historike për një sit të mundshëm? Të dhënat që kishim për praninë e një siti në këtë zonë ishin shumë të pakta. Gjatë viteve 1980 na janë sinjalizuar nga B. Jubani zbulimi aksidental i disa varreve të periudhës antike të vonë nga punimet bujqësore në zonë. Ndërsa B. Lahi gërmoi në po këto vite një fontanë publike të shekullit të 2 p.e.s. edhe kjo e zbuluar aksidentalisht. Gjatë viteve 2016-2017 ekipi ynë, në kuadrin e dokumentimeve të të gjithë siteve që gjenden në territorin e Shkodrës, u përqendrua më shumë në Bushat, duke aplikuar një seri metodash joinvasive, të cilat na evidentuan praninë e shumë anomalive nën tokë që mund të përkonin me ndërtime antike. Megjithatë, hezitimi ishte shumë i madh dhe deri në momentin e fundit kishim dyshime për potencialin arkeologjik që siti ofronte. Këtë skepticizëm e nxiste edhe më shumë shfrytëzimi për një kohë të gjatë i këtij terreni si tokë bujqësore dhe më pas si një repart tankesh deri në fillim të viteve 1990. Këto dy aktivitete të zgjatura në kohë e kanë transformuar topografinë e qytetit të lashtë dhe në pamje të parë në ditët e sotme të duket pothuajse e pamundur që këtu mund të fshihej një qytet antik.

**- A do vijojë gërmimi?**

Të dhënat që po na jep gërmimi i këtij viti në Bushat janë shumë premtuese dhe po na shtyjnë për të programuar gërmime të tjera në sit. Synimi për vitin e ardhshëm është që gërmimi të fokusohet në pjesën e sipërme të qytetit. Të dhënat paraprake që ne kemi nga gjurmët në sipërfaqe na japin indikacion për një prani të dendur banesash në këtë zonë. Gjithashtu, në majë të kodrës kemi ndoshta gjurmë të një kulle tjetër të fortifikimit të qytetit. Vetë pozicioni i kodrës është shumë strategjik dhe ka fushëpamje të plotë, me pothuajse të gjitha fortifikimet e tjera në territor si Shkodra, Akrolisi, Beltoja, Renci, Ganjolla, Spathari, Vorfa etj. Pas analizimit të të dhënave që do të kemi nga gërmimet e vitit të ardhshëm do të fillojmë të mendojmë në mënyrë më të detajuar për një plan gërmimi sa më afatgjatë në Bushat.

**- Çfarë ju tërheq me shumë nga ky sit?**

Ajo që tërheq më shumë në këtë sit është identifikimi në të i një qyteti ilir të panjohur deri më sot. Shqipëria është një tokë e pasur nga pikëpamja arkeologjike dhe vendbanime të vogla apo monumente të veçuara gjenden shpesh, por identifikimi i një qyteti të tërë ndodh gjithnjë e më rrallë, pasi shumica e qyteteve ilire janë të njohura tashmë. Sfida jonë në vitet e ardhshme mbetet gjetja e emrit antik të këtij qyteti. Është pikërisht ky eksplorim drejt së panjohurës, që na shtyn të vazhdojmë gërmimet në këtë qytet në vitet në vazhdim.

Opinioni i Ditës

# Universitet privat apo publik?

Nga dr. Valbona Nathanaili

*(vijon nga faqja 1)*

... listimin e karakteristikave që i japin secilit grup, më shumë a më pak vlera. Një karakteristikë tjetër e debatit është synimi për t'i rreshtuar të dy llojet e universiteteve në dy llogore të kundërta, ose në dy kampe kundërshtare, ndërkohë që në pjesën më të madhe të vendeve është krejt e kundërta, sepse krahas synimit për ndërkombëtarizimin e tyre në nivel rajoni, bëhen gjithnjë e më shumë përpjekje për shkëmbime programesh e studentësh në nivel kombëtar.

Në këto radhë, synimi është pasurimi i këtij debati nga këndvështrimi i studentëve dhe moderimi nga pozitat komode të analizës së përgjigjeve të tyre.

Për këtë arsye, 179 studentëve të vitit të parë akademik 2017-2018, që ndjekin studimet me kohë të plotë në dy universitete publike: në Universitetin e Tiranës, konkretisht në Fakultetet Juridik dhe Ekonomik, si dhe në universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", konkretisht Fakultetin e Shkencave të Edukimit, iu kërkua t'i përgjigjeshin pyetjes se pavarësisht universitetit e programit që po ndiqnin, kë do të preferonin ndërmjet një universiteti publik dhe një universiteti privat. Preferenca identifikohej duke zgjedhur në një pyetësor, ndërmjet opsionit privat apo publik. Akoma, për secilën preferencë, studentëve iu kërkua të listonin, në mënyrë narrative, jo më shumë se tri arsye. Paraprakisht, gjej rastin të falënderoj shumë njerëz që më mbështetën në zhvillimin e tij, ndërkohë që theksoj dëshirën për të pasur përgjigjet e sa më shumë studentëve në universitete të tjera dhe përpiluar një hartë sa më të detajuar të zgjedhjeve të tyre. Gjithsesi, këto të dhëna paraprake janë të mjaftueshme për të hedhur bazat e një teorie.

Nga përgjigjet, 69.8% (ose 125 studentë) pohojnë se zgjedhin universitetin publik, ndërsa 30.2% (ose 54 studentë), pohojnë se do të preferonin të vazhdonin studimet në një universitet privat. Interesante është varësia e vendndodhjes gjeografike së universitetit, me preferencën e studentëve në zgjedhje. Kështu, nga 57 studentë të Fakultetit Juridik, Tiranë, vetëm 5 ose 8% pohojnë se do të preferonin të ndiqnin një universitet privat; në Fakultetin Ekonomik, Tiranë, nga 60 studentë, 22 prej tyre ose 37% pohojnë se do të preferonin të ndiqnin një universitet privat; në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, Shkodër, nga 62 studentë, 27 prej tyre ose 44% pohojnë se do të preferonin një universitet privat. Trendi i dëshirës për të vazhduar studimet në një universitet privat, që rritet me largimin nga kryeqyteti dhe në pamje të parë duket se është funksion vetëm i vendndodhjes, është një tregues edhe i cilësisë së vetë universitetit: sa më shumë dëshirë të kenë studentët të zgjedhin një universitet të një lloji tjetër, aq më të pakënaqur janë me cilësinë që u ofrohet.



Sa u takon arsyeve që zgjedhin dhe justifikojnë preferencat e studentëve, ndryshe nga sa besohet, tradita dhe historia e universitetit publik (*alias* shtetëror) nuk përbëjnë arsye kryesore për zgjedhje. Dhe as profesionalizmi!

Arsye kryesore është tarifa e ulët e shkollimit. Zgjedhja për shkak të tarifës së ulët të shkollimit e një universiteti publik paraqitet në këto shifra: nga 125 studentë që preferojnë universitetin publik, 31.2% (ose 39 studentë) nuk e listojnë fare si arsye tarifën, ndërsa për 62.4% (ose 78 studentë) tarifa është një nga arsyet, në mos e vetmja dhe 8 prej tyre nuk i përgjigjen pyetjes. Për grupin e dytë, në mënyrë më të detajuar, përgjigjet janë: 40% (ose 31 studentë) e listojnë si arsye të parë, 32% (ose 25 studentë) e listojnë si arsye të dytë, 7.8% (ose 14 studentë) e listojnë si arsye të tretë dhe 18% (ose 7 studentë) e listojnë si të vetmen arsye (8 studentë nuk i përgjigjen kësaj pyetjeje). Është interesant fakti që të gjithë studentët që preferonin të ndiqnin një universitet privat, i kishin plotësuar me shumë rregull dhe në mënyrë të detajuar arsyet që shpjegonin zgjedhjen, ndërkohë që të vetmit studentë që nuk i kishin plotësuar ishin ata që zgjidhnin një universitet publik.

Arsyeja që renditet e dyta në zgjedhjen e një universiteti të këtij lloji është profesionalizmi: 49.2% e listojnë si arsye. Arsyeja e tretë është besueshmëria, që referon vlerën e mirë të diplomës në tregun e punës dhe njohjen e saj: 55 studentë, ose 30.7% e kanë pjesë të arsyeve pro. Tradita dhe historia e universitetit publik, ndryshe nga sa mund të mendohet listohet si arsye për ndjekje nga vetëm 3.4%.

Në rastin kur zgjidhet si preferencë një universitet privat, profesionalizmi renditet si arsyeja kryesore, ndonëse në përqindje më të ulëta: 19.6% e tyre pohojnë zgjedhjen e privatit për shkak të profesionalizmit. Në këtë grup u përfshinë arsye të tilla, si: teknika më të avancuara dhe më efektive në mësimdhënie, më shumë mundësi për aktivitete, merr notën e merituar, studentët trajtohen si kolegë, studentët kanë vëmendjen e duhur dhe vlerësohen për aftësitë që kanë, janë seriozë, raport më i vogël student/pedagogë si dhe pjesëmarrje në universitete. Si arsye e dytë e fortë u renditën kushtet në universitetet private me 14%, ndërsa arsye e tretë u listua besueshmëria me 7.8%. Arsyet e vendit të tretë përbëhen nga pohime të kësaj natyre: lidhje e bashkëpunim me jashtë, krijohen kushte për punësim, më pak stres, informacion në lidhje me tregun, më shumë siguri (diploma e publikut nuk njihet në shumë vende të botës - diploma e privatit njihet jashtë), më shumë drejtësi, plotëson nevojat dhe merr parasysh të drejtat e studentëve. Grupi i vendit të fundit të arsyeve, përbërë nga vetëm 8 studentë ose 4.5%, është shumë i veçantë dhe karakteristikë vetëm për zgjedhjen e këtij lloj universiteti. Sipas perceptimit të studentëve, zgjedhja e një universiteti privat lidhet edhe me faktin që "provimet merren më kollaj", sepse në shtetëror pedagogët të marrin inat dhe ka korrupsion, ndërsa privati nuk ka korrupsion.

Pohimet e studentëve ndihmojnë për ta parë situatën në terma më konkretë. Ndërsa duke krahasuar universitetet private me ato publike, jemi më të qartë dhe të ndërgjegjshëm se çfarë nuk është bërë, ose është bërë e vazhdon të bëhet keq.

Opinioni i Ditës

# Një vit pas bllokadës, Katari ecën përpara edhe më i fortë



Hashim Ibrahim Al Sada

Si sot një vit më parë, më 5 qershor 2017, Arabia Saudite, Emiratet e Bashkuara Arabe, Bahreini dhe Egjipti njoftuan ndërprerjen e marrëdhënieve diplomatike me Katarin dhe vendosjen e një bllokade totale tregtare dhe lëvizjeje nga ajri, toka dhe deti ndaj shtetit dhe popullit të Katarit. Dy javë para kësaj, Agjencia e Lajmeve të Katarit (QNA) u piraterua duke publikuar deklarata të rreme në emrin e Emirit të Shtetit të Katarit.

Të katërta këto vende i imponuan Katarit një bllokadë të padrejtë, që nuk u mjaftua vetëm me njerëzit, por preku edhe kafshët (devetë), të cilat u dëbuan me forcë nga territori saudit brenda një afati disaorësh… E gjitha kjo ndodhi gjatë muajit të Ramazanit, në shkelje të shenjtërisë së këtij muaji dhe në kundërshtim me traditat arabe, parimet islame, normat diplomatike dhe politikën e fqinjësisë së mirë.

Bllokada na befasoi vërtet shumë ne katarianëve, pasi nuk e imagjinonim që vendet fqinje me lidhje të forta familjare me ne, do të ndërmerrnin një agresion të pabesë dhe një padrejtësi të tillë ndaj çdo gjëje katariane, jo për ndonjë faj tjetër përveç përkatësisë katariane dhe krenarisë për këtë përkatësi.

### AKUZAT DHE SHKELJET E BËRA NGA VENDET E BLLOKADËS

Për shkak të absurditetit të kauzës së tyre, vendet e bllokadës dështuan në mënyrë të përsëritur të gjejnë akuza konkrete ndaj Katarit. Herë akuzuan për mbështetje të terrorizmit, herë për afrimitet me Iranin dhe një herë tjetër për ndërhyrje në punët e brendshme të vendeve arabe. Sa herë që rrëzohej një akuzë, vendet e bllokadës nxirrnin një të re edhe më absurde se e mëparshmja dhe asnjëherë – të paktën deri në shkrimin e këtyre rreshtave – nuk paraqitën ndonjë dëshmi reale për të mbështetur pretendimet e tyre, edhe pse ka kaluar plot një vit që nga fillimi i krizës.

Pas gjithë këtij konfuzioni dhe absurditeti nga vendet e bllokadës, ishte e natyrshme që fuqitë e mëdha, veçanërisht Shtetet e Bashkuara dhe Europa të mos i besonin ato akuza e t'i hidhnin poshtë ato. Përkundrazi, fuqitë e mëdha vlerësuan në më shumë se një rast rolin aktiv të shtetit të Katarit në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit, si dhe kontributin e tij për ruajtjen e sigurisë dhe stabilitetit në rajonin e Gjirit.

Pavarësisht përpjekjeve të shumta ndërkombëtare dhe ndërmjetësimit të Kuvajtit për zgjidhjen e krizës, vendet e bllokadës i vazhduan aktet dhe qëndrimet e tyre agresore dhe përpjekjet për të cenuar sovranitetin dhe dinjitetin e Katarit. Ato u përpoqën ta dëmtojnë dhe demonizojnë Katarin në rang rajonal dhe ndërkombëtar me forma dhe mjete të ndryshme. Jo më larg se 10 ditë më parë, mediat amerikane zbuluan se Arabia Saudite dhe Emiratet e Bashkuara Arabe kanë shpenzuar shuma të mëdha parash për të "blerë" kompani lobuese dhe personalitete me ndikim në Shtetet e Bashkuara në mënyrë që ta drejtonin Uashingtonin kundër Dohas. Vendet e bllokadës përdorën spame e robotë kibernetikë në rrjetet sociale për të nxitur dëshpërimisht popullin e Katarit kundër lidershipit të tij. As fenë nuk e kursyen pa e përdorur për qëllime politike, duke privuar qytetarët e Katarit nga pelegrinazhi (haxhi dhe umre) si formë ndëshkimi. Madje, myftiu i Arabisë Saudite tha se "bllokada është në interesin e vetë katarianëve".

Për fat të keq, ky "interes (i supozuar) i katarianëve" ndikoi dhe dëmtoi rëndë kushtet sociale, humanitare, ekonomike, arsimore dhe shëndetësore të katarianëve studentë, pacientë, biznesmenë etj., që u dëbuan me forcë nga vendet e bllokadës. Shumë familje të përziera (mes banorëve të këtyre vendeve) u shpërbënë.

Këto shkelje u dokumentuan në shumë raporte të organizatave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ndërsa Komiteti Kombëtar i Katarit për të Drejtat e Njeriut ka skeduar dhjetëra-mijëra shkelje ndaj qytetarëve katarianë, madje edhe ndaj qytetarëve të vetë shteteve të bllokadës, të cilat pasi e humbën besimin tek qytetarët e tyre, miratuan një ligj arbitrar dhe të çuditshëm, që "kriminalizon dhe dënon simpatinë ndaj Katarit".

### MOTIVET QË SHTYJNË VENDET E BLLOKADËS TË SAJOJNË KRIZËN

Letra me 13 kërkesa që kanë vendet paraqitën për t'i dhënë fund bllokadës ndaj Katarit, hedh dritë mbi shumë aspekte që ndihmojnë për të kuptuar më mirë motivet që shtynë katërshen të nisin krizën aktuale të Gjirit dhe t'a zgjasin atë. Letra përfshinte kërkesa qëllimisht të pazbatueshme. Qëllimi real ishte t'a përulnin Katarin dhe ta vendosnin atë nën tutelën e tyre politike.

Ndër kërkesat më kryesore të përmendura në atë letër janë: Reduktimi i marrëdhënieve diplomatike me Iranin, mbyllja e bazës ushtarake turke në Doha, mbyllja e rrjetit mediatik Al Jazeera, ndërprerja e ndërhyrjes (së supozuar të Katarit) në punët e brendshme të vendeve fqinje, koordinimi i politikës ekonomike dhe të sigurisë së Katarit me politikat e fqinjëve, si dhe kërkesa për pagesën e një kompensimi monetar në favor të shteteve të bllokadës. Që në leximin e parë është e qartë për këdo që këto kushte nuk janë gjë tjetër veçse një përpjekje për shkeljen e sovranitetit të Katarit, kompromentimin e pavarësisë së vendimit të tij politik, shtypjen e zërit të tij dhe shantazhimin e tij. Gjithashtu, kërkesa e fundit tregon pastër lakminë e vendeve të bllokadës ndaj pasurive e resurseve të shtetit dhe popullit të Katarit.

Roli rajonal pionier i Katarit i fituar me mund e meritë dhe suksesi i tij në arenën ndërkombëtare në shumë fusha politike, kulturore e sportive ngjallën xhelozi dhe zili tek shtetet e bllokadës. Kjo e vërtetë u shpalos qartë kur Emiratet e Bashkuara Arabe i kërkuan paturpësisht Katarit të heqë dorë nga organizimi i Botërorit të Futbollit më 2022, në këmbim të heqjes së bllokadës ndaj tij dhe rikthimin e marrëdhënieve diplomatike.

Qëndrimi i Katarit në lidhje me krizën dhe lëvizjet e tij diplomatike

Nga ana tjetër, Katari u qëndroi besnik politikave të tij parimore dhe morale. Ai nuk ndërmori masa të ngjashme ndëshkuese ndaj qytetarëve të vendeve të bllokadës dhe as nuk i ndërpreu furnizimet me gaz Emirateve të Bashkuara Arabe, e cila 70% të nevojave të saj energjetike i mbështet tek gazi katarian. Katari është shprehur gjithmonë i gatshëm dhe i hapur ndaj çdo dialogu në funksion të zgjidhjes racionale të krizës, por refuzon diktatet e jashtme që cenojnë sovranitetin dhe pavarësinë e tij. Qëndrimet e ndershme dhe sjellja racionale në marrëdhëniet me të tjerët, përfshirë edhe me shtetet e bllokadës, e rritën nivelin e besimit të komunitetit ndërkombëtar tek shteti i Katarit.

Këtë gjë e kam vërejtur edhe në Shqipëri. Disa miq të mi zyrtarë shqiptarë më kanë shprehur në konfidencë mbështetje për Katarin në këtë krizë, por nuk do të donin që në publik të shfaqeshin në krahun e njërës palë kundër një tjetre. Personalisht kam ndjerë gjithashtu edhe simpatinë dhe solidaritetin e popullit mik shqiptar me popullin katarian gjatë kësaj periudhe krize.

Në këtë kuadër, vendet kryesore europiane, si dhe Departamenti i Shtetit dhe i Mbrojtjes së SHBA-ve, →

Opinioni i Ditës

# Ata po vijnë

Nga Ilir Kalemaj

(vijon nga faqja 1)

... milioni emigrantëve të paligjshëm, kandidatë për azilantë politikë dhe në kampet e refugjatëve. Në fakt, Italia bashkë me Greqinë janë vendet më të goditura nga fluksi emigrator që kulminoi me krizën siriane, por refugjatët kanë një gjeografi të gjerë që mbulon nga Libia në Pakistan, apo nga Iraku në Eritre e deri në Afganistan.

Së fundmi, kambana alarmi po bien mbi rritjen e fluksit të refugjatëve të luftës dhe emigrantëve të tjerë ekonomikë kryesisht nga vendet e mësipërme dhe që po përdorin Shqipërinë si vend transit. Pas mbylljes me gardh me gjemba nga ana e Hungarisë, një trend që u ndoq dhe u replikua edhe nga vende të tjera të Vishegradit, por edhe ndër fqinjët ballkanikë, për shembull Kroacia, një itinerar i ri, i cili sjell refugjatët dhe migrantët nga Greqia nëpër Shqipëri për të dalë në Mal të Zi dhe mandej në Bosnje Hercegovinë, Kroaci, Slloveni dhe me destinacion final Gjermaninë dhe Austrinë, i ka shqetësuar ndjeshëm si këto të fundit, ashtu dhe Komisionin Europian, dhe FRONTEX (Agjencinë Europiane të Kufijve dhe Rojës Bregdetare), e cila së fundmi vendosi të punësojë rreth 10 mijë roje kufiri, një pjesë të mirë të tyre për t'i vendosur përgjatë kufirit shqiptaro-grek. Ndërkohë, Mali i Zi ka marrë premtimin e Hungarisë për t'i asistuar me ngritjen e një muri me gjemba për të frenuar trafikimin e refugjatëve nga kufiri shqiptar.



Dhjetëfishimi i numrave përgjatë harkut kohor prej një viti e ka kthyer në akute këtë krizë menaxhimi, si dhe ka rritur peshën dhe profilin gjeopolitik të Shqipërisë në këto momente, ku vëmendja e publikut dhe politikës në përgjithësi është te hapja e negociatave. Por, dukshëm, në kalkulimet politike të Berlinit dhe Vjenës më shumë figuron roli dhe mundësia që ka Shqipëria për të ndaluar këtë fluks, ku më së fundmi këta refugjatë të gjorë denjuan të hedhin sytë edhe nga ne, se sa patetizmat e kryerjes së reformave të nisura dhe pabitisura, që si gjithnjë përfundojnë në kalendat greke përpara se të kenë progres kalendarik në agjendat publike. Është kjo edhe arsyeja kryesore e pritjes nga ana e kancelarit Kurz të kryeministrit Rama, se sa ndonjë mbështetje krahëhapur për ciklin reformator të liderit global. Pavarësisht kësaj, Shqipëria duhet të bëjë përgatitje serioze për një temë që ndonëse pjesërisht e fshehur nga debati publik, ka rrjedhoja të rëndësishme përsa i përket debatit etik, human, ekonomik, social dhe kulturor dhe është politikisht mjaft sensitive.

Janë mbi 65 milionë njerëz sot anembanë globit të zhvendosur brenda kufijve (rreth 12 milionë syresh) apo jashtë kufijve të tyre kombëtarë si shumica, pjesa më e madhe e të cilëve janë ose refugjatë lufte, ose emigrantë ekonomikë. Pa harruar këtu me miliona të tjerë viktima të trafikimit të qenieve njerëzore, nga të cilët e pësojnë më shumë gratë e fëmijët, një lloj holokausti i spastrimeve nacionale apo kulturore në kohë paqeje. Rreth 74 milionë njerëz në mbarë botën sot kërcënohen me kriza urie të shkaktuara nga konflikti apo mungesa e stabilitetit politik në vendet e origjinës. Për të mos folur këto për zona të tëra që kërcënohen nga rreziku i thatësirës, nga burimet e pamjaftueshme natyrore apo fenomene të tjera që lidhen me ngrohjen globale apo jo.

Ndërkohë, me gjithë vëmendjen kryesore që ka marrë Lindja e Mesme gjatë viteve të fundit për shkak të konflikteve në Irak dhe Siri, janë rreth 900 milionë afrikanë, kryesisht nga Afrika nënsahariane priten të zhvendosen deri në 2050-ën sipas të dhënave nga studiues të lëvizjeve demografike dhe kjo valë u bashkëngjitet flukseve migratore të Lindjes së Mesme apo Afrikës Veriore apo shteteve si Pakistani dhe Afganistani, prej nga kanë ardhur flukset kryesore të refugjatëve dhe azilantëve politikë në vitet e fundit. Këto shifra janë jashtëzakonisht shqetësuese se destinacioni i tyre kryesor ku mbi tre të katërtat janë të destinuar të mbërrijnë është Europa dhe rruga për në BE kalon kryesisht nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Një pjesë e mirë e tyre që do të mbërrijnë deri në 2050-ën, ku ndoshta deri atëherë do të kemi hyrë në BE, do synojë ta kthejë në stacion përfundimtar me status azilanti qëndrimin në këto vende, përfshirë Shqipërinë. Por a është i përgatitur vendi ynë për flukse të tillë?

Siç e thamë në krye të herës, së fundmi Shqipëria vihet për herë të parë qysh nga fillimi i konfliktit sirian në hartën e vendeve transit, pasi deri tani për arsye konjukture gjeografike apo ironie praktike të një vendi që eksportin kryesor të produkteve të viteve të tranzicionit ka pasur trafikimin, këta migrantë duket se qëllimisht apo jo e injoruan rrugëkalimin nëpër Shqipëri, duke na kursyer një hall tjetër. Ky fat ndoshta nuk ka për të zgjatur *ad infinitum* dhe është koha që vendi të përgatitet për një debat adekuat në këtë lëmë, i cili nuk mund të lërë indiferent as politikën kombëtare, duke qenë se kancelaritë ndërkombëtare dhe agjencitë europiane janë vënë tashmë në lëvizje dhe e shohin me shqetësim këtë punë.

---

← mbështetën që në ditët e para të krizës pozicionin parimor të Katarit. Shteti i Katarit i forcoi marrëdhëniet e tij me Shtetet e Bashkuara në të gjitha nivelet nëpërmjet Dialogut Strategjik mes dy vendeve, që u mbajt 30 janarin e kaluar. Katari forcoi marrëdhëniet edhe me fuqitë e tjera me peshë në arenën ndërkombëtare, si Britania e Madhe dhe Franca, krahas marrëveshjeve që lidhi me NATO-n në fillim të këtij viti.

Këto lëvizje diplomatike të Katarit bënë të dështojnë përpjekjet e shteteve të bllokadës për t'a izoluar atë ndërkombëtarisht. Diplomacia katariane, me mençurinë dhe forcën e argumenteve të saj ia doli të ndryshojë balancat e peshores së krizës në favor të Katarit. Sekretarit i ri amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, gjatë vizitës së tij në Riad në turin e tij të parë zyrtar jashtë Shteteve të Bashkuara, u dërgoi një mesazh të qartë sauditëve rreth domosdoshmërisë për t'i dhënë fund bllokadës, duke u thënë: "Mjaft është mjaft", – sipas burimeve brenda qarqeve zyrtare në SHBA.

Katari nuk u ndal me kaq, por që në orët e para të krizës nxitoi të forcojë marrëdhëniet dhe bashkëpunimin me vendet e rajonit si Kuvajti, Omani, Irani dhe Turqia, çka zbuti efektet e bllokadës ekonomike dhe ndihmoi në absorbimin e goditjes së parë. Falë menaxhimit të mirë të krizës, Katari mundi t'i kapërcejë pasojat e bllokadës, duke siguruar produktet ushqimore dhe lëndët e tjera bazë (bile me të njëjtat çmime që ishin para krizës përmes përdorimit të rezervave strategjike të mallrave), të sigurojë likuiditetin e nevojshëm për garantimin e stabilitetit ekonomik dhe financiar të vendit, si dhe të hapë rrugë të reja detare për transportin e mallrave e furnizimeve dhe gjetjen e tregjeve alternative.

Revista "The Economist" në numrin e saj të kaluar konfirmoi se Katari e tejkaloi krizën dhe arriti të garantojë sigurinë ushqimore dhe medicinale të vendit nëpërmjet projekteve dhe sipërmarrjes lokale për plotësimin e nevojave të tregut të brendshëm për produktet bujqësore, qumështin dhe lëndët e tjera bazë.

Fakte dhe shifra rreth arritjeve të Katarit, pavarësisht bllokadës

Nga ana politike, Katari arriti të sigurojë një kthesë të rëndësishme në qasjen ndërkombëtare e sidomos amerikane ndaj krizës, ku ndryshimi i qëndrimit të Presidentit Trump nga pozicioni i tij fillestar ishte më kryesori. Gjatë takimit të tij me Emirin e Katarit, Sheikh Tamim Bin Hamad Al Thani prillin e kaluar, Presidenti Trump vlerësoi lart rolin e Katarit në luftën kundër terrorizmit, duke theksuar se Katari është një nga të paktat vende që kanë nënshkruar memorandum mirëkuptimi dypalësh me Shtetet e Bashkuara në këtë drejtim. "Emiri i Katarit gëzon popullaritet dhe respekt të madh tek populli i tij. Ai është një mik i mirë imi, ne punojmë mirë bashkë dhe gjërat me Katarin po shkojnë mirë", tha ai.

Ajo çka kriza solli në të vërtetë, krejtësisht ndryshe nga ajo që synonte katërshja e bllokadës, është kriza se i bashkoi më tepër katarianët dhe i shtrëngoi më fort pas lidershipit të tyre. Kriza forcoi frymën e përkatësisë kombëtare dhe ngriti edhe më lart pozitën e Emirit të vendit, duke e kthyer atë në një hero kombëtar, fotot e të cilit sot janë përhapur në të gjithë vendin.

Nga ana ekonomike, Katari mori një sërë masash dhe vendimesh ekonomike dhe tregtare që kontribuuan në ngritjen e vëllimit të prodhimit vendas, diversifikimin e burimeve të të ardhurave kombëtare, si dhe në hapjen e tregjeve të reja.

Lista e arritjeve është e gjatë dhe nuk është qëllimi i këtij artikulli t'i përmendë të gjitha këtu, por ndër më kryesoret mund të veçohen:

Akti i Rregullimit të Investimeve të Huaja: Që i lejon investitorët e huaj të kenë 100% të aksioneve në shumicën e sektorëve ekonomikë, duke ndihmuar në futjen e kapitalit të huaj dhe nxitjen e zhvillimit ekonomik.

Rritja e kuotave të "Qatar Airways" në kompanitë e tjera ajrore: "Qatar Airways" miratoi së fundmi një strategji për të rritur flotën e saj të avionëve "Airbus", hapjen e linjave të reja në disa kryeqytete dhe qytete të rëndësishme. "Qatar Airways" bleu 49 % të kompanisë italiane "Meridiana", rreth 10 % të kompanisë "Cathay Pacific" të Hong Kongut dhe shtoi me 20% aksionet e saj në grupin "A.I.G." me bazë në Britaninë e Madhe.

Zgjerimi i Portit Ndërkombëtar "Hamad": I cili luajti një rol të rëndësishëm në thyerjen e bllokadës. Ky port ishte porta më e madhe për importin e mallrave dhe furnizimeve alternative pas mbylljes së tregjeve me vendet e bllokadës. Gjatë krizës, porti "Hamad" hapi një numër të madh linjash dhe destinacionesh detare, si Omani, India, Shangai në Kinë etj.

Rritja e prodhimit të gazit: Në qershor 2017, "Qatar Petroleum" vendosi të shtojë prodhimin e gazit natyror me 30%. Në shtator 2017, kompania nënshkroi marrëveshje për eksportin e gazit në Bangladesh për 15 vjet dhe nënshkroi një marrëveshje të ngjashme edhe me Turqinë për ta furnizuar me 1.5 milionë tonë gaz në vit për një periudhë trevjeçare.

Ulja e varësisë nga jashtë (self-sufficiency): Më parë, Katari importonte më shumë se 80 % të nevojave të tij për ushqim nga vendet e bllokadës. Me krizën aktuale, vendi miratoi dhe financoi projekte për të garantuar sigurinë ushqimore dhe medicinale dhe uljen e varësisë nga të tjerët për produktet e qumështit, mishit, pulave, prodhimeve bujqësore, blegtorale dhe ato peshkut. Pas këtyre masave, importet e Katarit për nevojat ushqimore janë ulur në rreth 40%, duke u zëvendësuar me produkte vendore të cilësisë së lartë.

Punimet për "FIFA WORLD CUP 2022": 90% e punimeve infrastrukturore për këtë Botëror pritet të përfundojnë në vitin 2019, pavarësisht bllokadës. Katari është vendi i parë arab që organizon një kompeticion botëror futbolli. Vendi po shfrytëzon të gjitha mjetet dhe forcat e tij për ta organizuar këtë ngjarje të rëndësishme në formë të përkryer dhe të veçantë, të denjë për Katarin dhe për mbarë rajonin arab.

Pavarësisht pasojave dhe dëmeve të shkaktuara nga bllokada, Katari sot është më i fuqishëm se kurrë më parë. Ai refuzoi t'i nënshtrohet diktatit nga jashtë, nuk lejoi cenimin e pavarësisë dhe sovranitetit të tij dhe tejkaloi të gjitha pengesat dhe planet dashakeqe të vendeve të bllokadës. Falë mbështetjes së Zotit, pastaj aftësisë së udhëheqjes, unitetit të popullit dhe solidaritetit nga ana e popujve dhe qeverive të botës së lirë, Katari kapërceu krizën kryelartë dhe me sukses. Sot Katari ecën përpara edhe më i fuqishëm.

**** I Ngarkuari me Punë në Ambasadën e Katarit, Tiranë***

---

## HOROSKOPI

**DASHI**

Është koha e përshtatshme për të kërkuar një ngritje në detyrë, ose për të fituar një vend pune që kërkon seriozitet dhe aftësi. Një vendim i papritur do të dalë se është i duhuri kundër çdo parashikimi pesimist. Provojeni!

**DEMI**

Jeni shpërndarë në shumë fusha. Ndiqni objektiva që ju lodhin dhe ju stresojnë. Mos vallë për hir të kësaj keni lënë mënjanë dashurinë? Dëshira dhe pasioni do të bëjnë që të kërkoni mundësi për të biseduar dhe bashkëpunuar me partnerin.

**BINJAKET**

Sot priten ulje dhe ngritje të humorit në lidhje me sqarime familjare, por jo përballje zënkash. Çlirohuni nga të tjerët. Vepronі sipas mendjes suaj në çdo mjedis, po u dashur fare t'u përshtateni ritmeve të të tjerëve.

**GAFORJA**

Keni mundësinë për të takuar persona dhe kultura të ndryshme, me tradita dhe mënyra të tjera jetese. Parashikohen udhëtime. Zgjidhni angazhimet, Pas pak do t'ju duhet të hiqni dorë nga orët e gjumit për të mbajtur ritmet e veprimtarisë.

**LUANI**

Një epror do që t'ju besojë një detyrë delikate dhe të rëndësishme. Tashmë e di që jeni disi kryelartë, por askush nuk e ka aftësinë tuaj. Urani dhe Saturni ju favorizojnë në veçanti të gjitha veprimtaritë tuaja artistike dhe krijuese.

**VIRGJERESHA**

Një realizëm i mirëfilltë dhe një sens praktik do të jenë zgjedhja e duhur për të luftuar rastësitë jo të favorshme që do t'ju dalin për të përballuar. Me Mërkurin që nuk ju mbështet, do të keni prirje të gjykoni të tjerët edhe për gjëra të kota, përpiquni të jeni më realistë.

**PESHORJA**

Nuk mund t'i mohoni më faktet. Duke parë që një ngjarje e vjetër shfaqet vazhdimisht, më mirë të përballeni njëherë e për gjithmonë për ta lënë pas. Do të jeni të disponueshëm dhe me humor të mirë. Do të shijoni anën e këndshme të dashurisë.

**AKREPI**

Nuk të humbni vëmendjen nga interesat tuaja për të vrapuar pas angazhimeve të përditshme dhe çështjeve praktike. Keni nevojë për lëvizje, për ajër të freskët dhe të pastër për t'u mbushur me frymë. Organizoni një udhëtim në një zonë detare.

**SHIGJETARI**

Sot marrëdhëniet tuaja do të jenë më të fuqishme. Mund të ndryshoni mendje për një eveniment. Do të keni takime të mrekullueshme që do t'ju ndryshojnë jetën e dashurisë apo do të forcojnë lidhjet ekzistuese.

**BRICJAPI**

Të papritura të këndshme në familje. Përditshmëria do të jetë më emocionuese dhe e këndshme, edhe pse do t'ju ndodhë që të ndryshoni menjëherë programin. Do të jeni në lartësinë e duhur për të marrë vendime shumë delikate. Do të fitoni kështu vlerësimin e një eprori..

**UJORI**

Të papritura të këndshme në familje. Përditshmëria do të jetë më emocionuese dhe e këndshme, edhe pse do t'ju ndodhë që të ndryshoni menjëherë programin. Do të jeni në lartësinë e duhur për të marrë vendime shumë delikate. Do të fitoni kështu vlerësimin e një eprori.

**PESHQIT**

Keni shumë pritshmëri ndaj një personi që ndoshta nuk do të tregohet në lartësinë e duhur. Do të ishte më mirë të përqendroni vëmendjen diku tjetër. Mos u bëni kokëfortë! Keni dëshirë të madhe të imponoheni në të gjitha rrethanat.

Italiani flet në një intervistë dhënë në orët e vona të natës për faqen e FSHF-së në youtube

# Panuçi: S'kishim benzinë, shkarkimin nuk e mendoj!

## *Premtoi një Shqipëri sulmuese, por pranon "black out"-in*



Jeton Selimi

8 ndeshje në krye të stolit kuqezi, 8 forma cione të ndryshme të servirura nga Kristian Panuçi. Natyrisht që kur sheh këtë bollëk lojtarësh, mendimet që të vijnë në kokë janë dy: ose trajneri italian po vijon me sukses revolucionin e tij, ose Kombëtarja është në kolaps dhe ish-ët e suksesshëm nuk po zëvendësohen dot. Natyrisht, shpresojmë të mos jetë kjo e dyta, por duke parë rezultatet e fundit është e kotë ta fshehësh dyshimin!

Por trajneri i Kombëtares, Krisian Panuçi foli për kanalin zyrtar të FSHF-së në "Youtube" për humbjen e thellë ndaj Ukrainës, duke analizuar me detaje këtë disfatë dhe gjendjen jo të mirë të skuadrës. Tekniku italian kërkon të largojë panikun dhe premton që skuadra do të rikthehet si më parë, me rikthimin e të gjithë lojtarëve. Kujtojmë që trajneri Panuçi nuk u lejua nga tifozët shqiptarë, që të jepte prononcimin pas ndeshjes. Ata i kërkuan trajnerit të largohej duke përmendur emrin e De Biazit.

**Mister, skuadra nuk funksionon, nuk arrin ta ndezë zjarrin, çfarë nuk shkon?**

Asgjë kaq e rëndë dhe kaq katastrofike, sikurse duan që të duket. Kemi zhvilluar dy ndeshje shumë negative, sepse skuadrës i kishte mbaruar benzina. Kishim shumë vështirësi, sepse ne nuk jemi Brazili apo Franca. Jemi pa Bashën, Xhakën, Memushajn, Grezdën, Sadikun. Mavraj ka 5 muaj që nuk luan, Memolla, gjithashtu, kishte 5 muaj pa luajtur. Ukraina kishte të gjithë lojtarët e Shaktarit dhe të Dinamos së Kievit, pra kishte tjetër cilësi. Në këto momente, nëse nuk rikuperojmë të gjithë lojtarët e rëndësishëm, vuajmë shumë. Jam mëse i bindur që kur të rikthehen futbollistët e rëndësishëm, ata që fituan në Turqi, ata që zhvilluan ndeshjen kundër Italisë dhe ata që gjuajtën drejt portës së Spanjës plot 15 herë, atëherë do të jemi konkurrues.

**Kombëtarja e dy ndeshjeve të fundit nuk ishte e tillë. Pse duhet të mendojmë që do të përmirësohemi në të ardhmen, kur pas humbjes 3-0 me Kosovën, u mposhtëm 4-1 edhe me Ukrainën?**

Sepse skuadra gjithmonë ka bërë mirë, sepse në fund të sezonit lojtarët ishin shumë të lodhur. Kishin pushuar për 15 ditë, pastaj erdhën në kombëtare. Nuk më pëlqen të shfajësohem, por bateritë kishin rënë plotësisht. Më vjen keq dhe jam shumë i zhgënjyer dhe i trishtuar si të gjithë shqiptarët, por është e pamundur që kjo të jetë ajo skuadër që fitoi me Turqinë. Kjo është krejt ndryshe, me shumë të rinj. Duhej të provoja shumë të rinj, të rrezikoja, që të shihja nëse dikush ishte gati për kombëtaren. Në shtator, kur të kthehen të gjithë lojtarët, skuadra do të jetë kompetitive.

**3 ndeshje, 8 gola të pësuar dhe vetëm një i shënuar. A nuk mendoni se është përkeqësuar shumë gjendja? Si mund të dilet nga kjo situatë?**

Skuadra nuk ka bërë mirë në fazën mbrojtëse. Mavraj është një element shumë i rëndësishëm për ne, por ne 5 muajt e fundit nuk ka luajtur. Edhe në mesfushë kemi humbur lojtarë të rëndësishëm, ndaj ishim të cenueshëm. Isha unë i pari, që e dija këtë. Por jam i sigurtë që kur të vijnë kualifikueset dhe të kthehen lojtarët, do të bëjmë shumë më mirë.

**Keni ardhur me mendimin për të ndërtuar një skuadër sulmuese, por me ç'shihet, nuk kemi asnjë mundësi për të qenë të tillë?**

Nuk kishim forcë, nuk kishim këmbë. Nuk kishim mendimin për të sulmuar. Edhe ndaj Ukrainës luajtëm vetëm 20-25 minuta, më pas "black out" total dhe erdhi goli i parë. Duhet ta pranojmë situatën, duke shpresuar që të na kthehen shumë futbollistë.

**Çfarë do të thotë e kritika e duhur?**

Kjo e duhura dhe e ekuilibruar, kur vlerësohen të gjitha situatat. Zhvilluam dy ndeshje negative, por ne nuk kemi 60 lojtarë. Kur na mungojmë vetëm 5-6 futbollistëve, shndërrohemi në një skuadër shumë më pak konkurruese. Ky është realiteti.

**A mendoni akoma që kjo skuadër duhet të luajë në sulm?**

Absolutisht po, sepse mendoj se është e drejtë të bëjmë kështu, kur të kthehet Grezda, kur Roshi të jetë mirë, Sadiku të jetë mirë dhe Manaj të jetë mirë. Do të provojmë të luajmë. Në këto dy ndeshje problemi nuk qëndronte te taktika mbrojtëse, apo sulmuese. Nuk kishim as kokën dhe as këmbët.

**Po pse nuk u grumbullua Sadiku, që është një sulmues, i cili ka luajtur pak më shumë se Cikalleshi?**

Në katër muajt e fundit, Cikalleshi ka luajtur shumë më tepër se Sadiku. Ishte e drejtë që të thërrisja atë që kishte më shumë minuta në këmbë. Por në ardhmen, nëse do të luajë, do të grumbullohet.

**Je i trishtuar?**

I keqardhur, sepse kemi humbur. Duhet të presim dy muaj për ndeshjet e tjera, por jam i bindur se, kur të jemi të gjithë bashkë, do të bëjmë një skuadër që të mirë dhe do të provojmë të shkojmë në Europian.

**Gazetarët pretendojnë se ndoshta nuk po merrni përgjigjet e duhura nga skuadra. A ju kuptojnë futbollistët?**

Në këto dy ndeshje e fundit ishte e vështirë, sepse ishin me pushime. Për mua ishte shumë e vështirë t'u ndizja dritën. Nuk ja dola, sepse u kishte mbaruar benzina. Gjithsesi, jam i bindur që skuadra më ndjek dhe se në shtator do të jetë krejt ndryshe.

Jeni shprehur se lojtarët kanë talent, kanë potencial, por kjo nuk po shihet...

Nuk është se nuk po shihet, por nuk kishim gjysmën e formacionit titullar. Ne jemi ekip kombëtar, por nuk kishim shumë lojtarë të rëndësishëm si Xhaka, Grezda, Memushaj, Basha. Mavraj ka 5 muaj që nuk luan dhe në nivel ndërkombëtar këto gjëra peshojnë shumë.

Të gjitha pyetjet lidhen për një mbrojtje me shumë probleme...

Në këto momente kemi shumë problem, sepse mund të bëjmë pak ndërrime. Kemi Ajetin, që nuk luan te Krotone, Veseli ka luajtur një ndeshje në muajin e fundit, Mavraj 5 muaj pa luajtur. Shpresoj që Mavraj të gjejë shumë shpejt një ekip të ri, sepse është shumë i rëndësishëm për ne dhe duhet të luajë.

**Kështu siç po shkojnë gjërat, e ndiheshi rrezikuar?**

Për momentin, absolutisht jo, sepse kemi ekuilibrat e duhur për të kuptuar që në nëntor gjërat shkonin mirë, me Norvegjinë, brenda ndeshjes. Nëse mendojmë që duhet t'i fitojmë të gjitha ndeshjet, atëherë gabojmë gjithçka. Nëse jemi të gjithë të bashkuar, atëherë mund t'ia dalim. Mund të humbasim, edhe të fitojmë. Nuk e mendoj aspak këtë rrezik, jam shumë i bindur në punën time.

**Si mund të humbasim 4-1 pa marrë një karton të verdhë?**

Për këtë i pyeta edhe lojtarët në dhomat e zhveshjes. Pati shumë pak grintë, sepse lojtarëve iu mungonte forca. Kemi luajtur më mirë me Ukrainën se ndaj Kosovës. Ukraina është shumë më e fortë se Kosova, kjo na bën të kuptojmë shumë gjëra.

Por diçka mungon këssaj skuadre...

I mungonin 7 lojtarë.

Jo vetëm për sot.

Përkundrazi, në Turqi kishim "fenomenë". Ishim një skuadër e madhe, që luante dhe dëfrente. Tani mungojnë 7 futbollistë nga ajo skuadër. Sot mungon gjithçka.

Pas miqësores me Kosovën u shprehet se mungon "zjarri", futbollistët ndaj Ukrainës ishin më mirë fizikisht.

Jo, vetëm gjysmëorën e parë. Pastaj, skuadra nuk reagoi si duhet në kokë, por ky është një moment i veçantë i sezonit.

**A i qëndroni deklaratës suaj, kur e morët detyrën, se për këtë skuadër të gjithë duhet të ketë më shumë respekt?**

Po, por unë nuk i shoh këto gjëra, jam i përqendruar në punën time. Ku fiton, je i zoti, por kur humbet, merr shumë kritika. Unë përpiqem të jem i ekuilibruar, të kuptoj momentin dhe pse kanë ardhur këto humbje, duke e ditur që kjo nuk është Shqipëria ime. Mund të humbasësh, por jo pa luftuar. Jam i bindur se në të ardhmen do të rigjej Shqipërinë time. Nuk më mbetet gjë tjetër, veç të qëndroj në qetësi, të punoj dhe të shpresoj që të rikuperoj futbollistët e mi.

**Do të vijojë puna?**

E përse nuk duhet të vijojë?

E kam fjalën për udhëtimet që duhet të bëni për të parë lojtarë.

Duhet të shoh edhe 2-3 lojtarë, por deri në shtator grupi duhet të jetë formuar. Kam bërë shumë eksperimente, kam parë shumë lojtarë të rinj dhe kemi kuptuar shumë gjëra. Shpresojmë që në shtator t'i rikuperojmë të gjithë dhe ta marrim shumë seriozisht.

**Të bezdisin reagimet në Shqipëri, madje edhe të ish-politikanëve.**

I kuptoj dhe i lë të flasin. Kuptohet që kur je trajner i kombëtares merr shumë kritika. Unë jam i ndershëm dhe besnik, punoj me shumë qetësi dhe kërkoj më të mirën për Shqipërinë. Do të vazhdoj ta bëj detyrën time, sepse presidenti më ka dhënë besim. Deri në nëntor flitej për një Shqipëri sulmuese dhe po ndryshonte. Duhet të kemi ekuilibër, të besojmë në punën tonë dhe ta bëjmë me shumë qetësi. Por, kur të shkoj në luftë, dua t'i kem me vete të gjithë luftëtarët e mi. Në dy ndeshjet e fundit, nuk i pata luftëtarët.



**8 NDESHJET E PANUÇIT**

| | |
|---|---|
| Shqipëri - Lihtenshtejn | 2-0 |
| Fyrom - Shqipëri | 1-1 |
| Spanjë - Shqipëri | 3-0 |
| Shqipëri - Itali | 0-1 |
| Turqi - Shqipëri | 2-3 |
| Shqipëri - Norvegji | 0-1 |
| Shqipëri - Kosovë | 3-0 |
| Shqipëri - Ukrainë | 1-4 |

**8**

**DEBUTIME**

Në drejtimin e Panuçit. E kanë veshur për herë të parë fanellën kuqezi Bujar Lika, Hysen Memolla, Enis Gavazaj, Emanuele Ndoj, Ylber Ramadani, Kamer Qaka, Kristal Abazaj dhe Sindrit Guri.

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

Tashmë edhe lundroni!

